



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 14 regjistër (JR)
Datë 04.03.2019

Nr. 17 i vendimit
Datë 15.07.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Luan Daci	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 15.07.2020, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket ankimit:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Agron Vavla, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 94, datë 21.12.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 62-65 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, nëpërmjet të cilave kërkoi ndryshimin e vendimit

nr. 94, datë 21.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 94, datë 21.12.2018, ka vendosur *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Agron Vavla, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.*
2. Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), në bazë të neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), në bazë të neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016 dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”), në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, pa përfshirë në vendim kriterin e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit profesional.
3. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit për vlerësimin e pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Agron Vavla arriti në konkluzionet:
 - i. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 57,1 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Berat, subjekti i rivlerësimit *ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin çmimin e këtij apartamenti.*
 - ii. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 17 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit: *i) ka paraqitur në mënyrë të pasaktë çmimin e këtij apartamenti në pronësi dhe ka fshehur çmimin real; ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti dhe garazhi në shumën prej -2.590.429 lekësh; iii) ka kryer deklaram të rremë në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, pasi nuk arriti të provojë se kishte të ardhura të ligjshme nga kursimet familjare; iv) ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor provues në lidhje me të ardhurat e z. K.Sh., për të provuar mundësinë financiare nga burime të ligjshme të tij, për të dhënë këtë hua; v) ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë burimi të ligjshëm financiar në deklaratën e pasurisë “vetting”, për shumën 1.580.000 lekë, për apartamentin me sip. 110,8 m², në rr. “{***}”, në Tiranë, në vitin 2015.*
 - iii. Për pasurinë automjet BMW, X3, subjekti i rivlerësimit: *i) ka paraqitur në mënyrë të pasaktë çmimin e blerjes së këtij automjeti pasi nuk provoi me dokumentacion ligjor se çmimi i blerjes së këtij automjeti ishte në vlerën 10.000 euro; ii) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar blerjen e këtij automjeti në vitin 2012, një diferencë me minus në vlerën prej 141.495 lekësh.*
 - iv. Për pasurinë letra me vlerë në obligacione thesari në Raiffeisen Bank, subjekti i rivlerësimit *ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar dy depozitat e krijuara: (1) pranë “ProCredit Bank” në shumën 3.600 euro +*

320.000 lekë dhe (2) pranë “Raiffeisen Bank” në shumën prej 185.571 lekësh, depozita të cilat kanë shërbyer si burim fillestar për krijimin e shumës 2.100.000 lekë.

- v. Në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur/djali i subjektit, E.V., subjekti i rivlerësimit: i) ka fshehur në deklaratën “vetting” të vitit 2017, detyrimin e personit të lidhur/djalit të tij ndaj shtetasit L.B., në shumën 18.230,90 USD, transferuar në vitin 2016; ii) nuk provoi se sponsorizuesi L.B. kishte mundësi financiare nga burime të ligjshme për të dhënë huan në vitin 2016 dhe më tej në vitin 2017; iii) ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shkollimin dhe akomodimin e personit të lidhur/djalit të tij në ShBA.
 - vi. Për analizën financiare për periudhën 2003 – 2016 të subjektit të rivlerësimit, bazuar në të dhënat e INSTAT-it dhe anketën familjare të vitit 2006 po nga INSTAT: i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të mjeteve financiare nga burime të ligjshme nga viti 2003 deri në vitin 2016, në shumën -5.708.665 lekë, për të justifikuar deklaramet e bëra ndër vite.
4. Në përfundim të procesit të rivlerësimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni arriti në përfundimin që subjektit të rivlerësimit Agron Vavla, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

II. Shkaqet e ankimit

- 5. Kundër vendimit nr. 94, datë 21.12.2018, të Komisionit, është ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) nga subjekti i rivlerësimit Agron Vavla, i cili kërkon ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë.
- 6. Shkaqet e ankimit lidhen kryesisht me çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale, procesit të rregullt ligjor, si dhe me vlerësimin që ka kryer Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë.
- 7. Shkaqet e ankimit që lidhen kryesisht me çështje të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale dhe procesit të rregullt ligjor në mënyrë të përmbledhur, janë si vijojnë.
 - a. Procesi administrativ, seanca dëgjimore, si dhe vendimmarrja e Komisionit janë kryer në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 4 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016.
 - b. Komisioni ka harruar të përmendë se Agron Vavla i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio* jo vetëm për shkak të funksionit të tij si gjyqtar, por dhe si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
 - c. Procesi i rivlerësimit në Komision, vetëm për kriterin e pasurisë, është bërë në shkelje të përcaktimeve kushtetuese dhe nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, ku në asnjë rast nuk parashikohet kompetenca e Komisionit për të mbyllur procesin vetëm për një kriter.
 - ç. Bazuar në parashikimet e nenit 145, paragrafi i dytë i Kushtetutës, Kolegji të pezullojë gjykimin dhe të dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese për interpretim, ose në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për të vlerësuar nëse procesi i rivlerësimit dhe

- vendimmarrja e bazuar vetëm për një kriter është në përputhje me Kushtetutën dhe nëse plotëson kushtet për një proces të rregullt.
- d. Vendimi i Komisionit, i cili referon nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është i gabuar, i pabazuar, si dhe në kapërcim të ligjit.
 - dh. Masat disiplinore të shkarkimit, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016, nuk janë të parashikuara shprehimisht nga Kushtetuta, as nuk është deleguar prej saj mundësia e parashikimit me ligj të rasteve të tjera të shkarkimit.
 - e. Bazuar në nenin D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme.
 - ë. Komisioni ka cenuar standardin për një proces të rregull ligjor, ka shkelur parimin e barazisë së armëve, parimin e kontradiktoritetit dhe të drejtës për një proces gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.
 - f. Arsyetimi i vendimit të Komisionit përmban pasaktësi, shprehje të cilat nuk kanë lidhje me këtë proces apo shprehje të paqarta që nuk tregojnë bazueshmërinë e vendimmarrjes.
 - g. Arsyetimi i vendimit duhet të përmbajë një parashtrim të përmbledhur të rrethanave të faktit, provat mbi të cilat bazohen, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 66, datë 10.11.2017 dhe nr. 3, datë 20.01.2017). Mosplotësimi i këtyre kriterëve e bën vendimin e pavlefshëm.
 - gj. Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me nenet 30, 31, 32 të ligjit nr. 84/2016, pasi objekti i veprimtarisë së tij është kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, dhe jo i saktësisë apo pasaktësisë së deklaratave të bëra në vite në ILDKPKI.
 - h. Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, nenet 6, 7, 8, 13, 14 të KEDNj-së dhe protokollit shtesë të saj. Nga Komisioni janë shkelur të drejtat e njeriut për një proces të rregullt ligjor, si: e drejta e privatësisë familjare, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e drejta e mosndëshkimit pa faj, e drejta për një proces të pavarur.
 - i. Gjatë hetimit administrativ, mënyra e ndërtimit të pyetjeve, oraret e dërgimit të pyetjeve, koha e shkurtër e lënë në dispozicion për të paraqitur prova e dhënë shpjegime për fakte dhe rrethana të ndodhura shumë vite më parë, kërkimi i informacioneve dhe të dhënave të panevojshme të familjarëve që mund të kenë lidhje me personat e lidhur me subjektin, tregojnë se qëllimi i Komisionit nuk ka qenë sqarimi i situatave të paqarta, por krijimi i një situatë stresi, mbajtja e subjektit në gjendje ankthi, presioni për sigurinë dhe vazhdimësinë në detyrë, si dhe për të krijuar kurthe që vendosin subjektin në gabime njerëzore.
 - j. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenet 49, pika 9 dhe 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi refuzimi i kërkesës së subjektit për marrjen dhe kërkimin e provës duhej të bëhej me vendim të arsyetuar.
 - k. Komisioni, për të arritur në përfundimin e rezultatit të hetimit administrativ, kryesisht vetëm për kriterin e pasurisë i duhej një periudhë 15.01.2018 deri 05.12.2018, ndërkohë që subjekti jo më vonë se 10 ditë nga marrja e njoftimit, duhej të njihej me dokumentacionin e dosjes, të bënte kërkesë për thirrje apo marrjen e çdo prove mbështetëse, si dhe të paraqiste shpjegime me shkrim për rezultatet e hetimit.
 - l. Vendimi i Komisionit është në kundërshtim me vendime të tjera të tij të dhëna para dhe pas këtij vendimi, duke mbajtur kështu qëndrim selektiv dhe diskriminues në shkelje të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollit respektiv.

8. Shkaqet e ankimit që lidhen me themelin e gjykimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në mënyrë të përmbledhur janë si vijojnë.

- a) Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 17,20 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, Komisioni ka gabuar në konkluzionin se subjekti ka paraqitur në mënyrë të pasaktë çmimin e apartamentit dhe ka fshehur vlerën reale të tij, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, ka kryer deklaram të rremë për burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, nuk mund të provonte se kishte të ardhura nga kursimet familjare, ka mungesë të dokumentacionit ligjor provues në lidhje me të ardhurat e K.Sh. për të provuar mundësinë financiare të tij nga burime të ligjshme për të dhënë huan, pasi në interpretim të provave të administruara dhe analizës financiare të paraqitur nga subjekti, provohet e kundërta.
- b) Për pasurinë automjet BMW, X3, Komisioni ka gabuar në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë çmimin e blerjes së automjetit dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar blerjen e tij, pasi në interpretim të provave të administruara, akteve të dosjes së zhdoganimit të automjetit, të analizës financiare të paraqitur prej subjektit, provohet e kundërta.
- c) Për pasurinë *letra me vlerë në obligacione thesari në Raiffeisen Bank*, Komisioni ka gabuar në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar depozitat që kanë shërbyer si burim fillestar për krijimin e kësaj pasurie, pasi në interpretim të provave të administruara, analizës financiare dhe provave të tjera të paraqitura nga subjekti, provohet e kundërta.
- ç) Sa i përket personit të lidhur, djalit të subjektit E.V., Komisioni ka gabuar në konkluzionin e tij se subjekti ka fshehur në deklaratën e pasurisë *vetting* detyrimin e personit të lidhur ndaj z. L.B., nuk provoi se ky i fundit kishte mundësi financiare të ligjshme për të dhënë këtë hua në vitet 2016 dhe 2017, ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për shkollimin dhe akomodimin e djalit në ShBA, pasi në interpretim të provave të administruara, si dhe provave të paraqitura nga subjekti, provohet e kundërta.
- d) Për analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, Komisioni ka gabuar në konkluzionin e tij se subjekti ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të mjeteve financiare për të justifikuar deklaramet e bëra ndër vite, pasi nga provat e administruara dhe analiza financiare e paraqitur nga subjekti, provohet e kundërta.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

9. Çështja në dhomë këshillimi u mor në shqyrtim në bazë të ankimit të subjektit kundër vendimit nr. 94, datë 21.12.2018, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shqyrtimin e çështjes në seancë dëgjimore me qëllim ribërjen e hetimit administrativ, si dhe:

i. Marrjen dhe administrimin në cilësinë e provës:

- të kontratës së shitjes me kusht të pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.08.2015, lëshuar nga notere E.J., në Tiranë;

- të kontratës së shitjes me kusht të pasurisë së paluajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.12.2015, lëshuar nga notere E.B.J., në Tiranë;
 - të kartës së identitetit (*Carta d'identita* nr. {***}) të shtetasit shqiptar K.Sh.;
 - të dokumentit të datës 13.12.2018, lëshuar nga Kompania “{***}”, për punësimin e z. K.Sh. pranë kësaj kompanie me vendndodhje në {***}, Itali, me kontratë të përhershme nga data 07.01.2002 e vazhdim;
 - të shkresës nr. {***} prot., datë 07.12.2018, lëshuar nga Komisariati i Policisë Berat, mbi hyrje-daljet e shtetasit K.Sh., për periudhën 2005-2018;
 - të shkresës nr. {***} prot., datë 11.12.2018, lëshuar nga Drejtoria Doganore, Berat, dhe të kopjes së njësuar me origjinalin e praktikës doganore {***}, datë 13.01.2013;
 - të shkresës nr. {***} prot., datë 11.12.2018 dhe nr. {***} prot., datë 11.12.2018, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat, mbi vjetërsitë në punë të shtetasve L. dhe L.B., për të provuar një nga burimet e ligjshme të pasurisë së familjes B.;
 - të aktit të ekspertimit mbi analizën ekonomiko-financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit Agron Vavla, për periudhën 31.12.2012 deri 31.12.2016, kryer nga eksperti privat B.Ç.
- ii. Pyetjen në cilësinë e dëshmitarit të z. K.Sh.
- iii. Kryerjen e akteve të ekspertimit: i) për analizën financiare të viteve 2003-2016 të subjektit të rivlerësimit në bazë të nenit 229 të Kodit të Procedurës Civile; ii) për të përkthyer dhe interpretuar aktet e ardhura nga ShBA dhe Itali.
10. Trupi gjykues, pasi mori në konsideratë kërkesën e subjektit, konstaton se dokumentacioni i kërkuar nga subjekti për t'u marrë në cilësinë e provës, është administruar dhe shqyrtuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe nuk përbën provë të re. Në arsyetimin¹ e vendimit nr. 94, datë 21.12.2018, të Komisionit, trupi gjykues vëren se është trajtuar edhe kërkesa e subjektit për pyetjen në cilësinë e dëshmitarit të z. K.Sh.
11. Subjekti i rivlerësimit pas marrjes së njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, më datë 15.07.2020, nuk paraqiti në Kolegj parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

III/1 Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

12. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se procesi administrativ, seanca dëgjimore, si dhe vendimmarrja e Komisionit janë kryer në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 4 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi aktet e administruara në dosjen gjyqësore dhe procesin e rivlerësimit në Komision, vlerëson se procesi i hetimit administrativ, seanca dëgjimore, si dhe vendimmarrja e Komisionit janë realizuar në përputhje me parimet e ligjshmërisë, drejtësisë dhe paanësisë, proporcionalitetit, dhënies së një vendimi të bazuar në ligj e në prova, duke respektuar të drejtat për një proces të rregullt ligjor.*
13. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit se *Komisioni ka harruar të përmendë se Agron Vavla i nënshtrohet procesit të rivlerësimit ex officio, jo vetëm për shkak të funksionit*

¹ Shih paragrafin 2.38 të vendimit të Komisionit.

të tij si gjyqtar, por dhe si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, nuk qëndron, pasi bazuar në pikën 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar *ex officio* procesit të rivlerësimit, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, dhe mospërmendja nga Komisioni e faktit që subjekti ka qenë kryetar i kësaj gjykate nuk ndryshon procedurat e ndjekura për procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se vetë subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore është shprehur se mandati i tij si kryetar i gjykatës ka mbaruar më 29.06.2018 dhe prej kësaj date ishte pa mandat kryetari dhe vazhdonte seancën dëgjimore në cilësinë e gjyqtarit.

14. *Pretendimin e subjektit në ankim se procesi i rivlerësimit të Komisionit, vetëm për kriterin e pasurisë, është bërë në shkelje të përcaktimeve kushtetuese dhe nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, ku në asnjë rast nuk parashikohet kompetenca e Komisionit për ta mbyllur procesin vetëm për një kriter, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pabazuar, pasi vendimi i Komisionit është marrë në përputhje të plotë me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili përcakton qartë se: Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave. Trupi gjykues vëren se Komisioni në pikat 12 dhe 13 të vendimit të tij, ka arsyetuar drejt zhvillimin e hetimit administrativ dhe marrjen e vendimit vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë. Trupi gjykues gjithashtu çmon se Komisioni ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore që lejojnë vlerësimin edhe vetëm për një kriter, duke mos e konsideruar paragjykes vendimin e Komisionit ndaj subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, trupi gjykues e konsideron vendimmarrjen e Komisionit, të mbështetur vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, të drejtë dhe të bazuar në ligj, si dhe në përputhje me qëndrimin e mbajtur edhe në çështje të tjera të ngjashme të shqyrtuara nga Kolegji².*
15. *Lidhur me pretendimin e subjektit se bazuar në parashikimet e nenit 145, paragrafi i dytë i Kushtetutës, Kolegji të pezullojë gjykimin dhe të dërgojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese për interpretim, ose në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për të vlerësuar nëse procesi i rivlerësimit dhe vendimmarrja vetëm për një kriter është në përputhje me Kushtetutën dhe me një proces të rregullt ligjor, trupi gjykues vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e zbatimit të një ligji që çmohet se vjen në kundërshtim me Kushtetutën, për të pezulluar gjykimin sipas parashikimit të kësaj dispozite³. Në kuadër të juridiksionit kushtetues për të vendosur mbi pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 131, pika 1, germa “a” e Kushtetutës ka shqyrtuar pajtueshmërinë e ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, ka rrëzuar kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” [...]. Gjykata Kushtetuese gjithashtu, në paragrafin 67 të këtij vendimi, është shprehur se: Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e*

² Shih vendimet nr. 29, datë 08.11.2019; nr. 1, datë 31.01.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

³ Neni 145, pika 2 e Kushtetutës: “2. Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat”.

drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...]. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

16. *Subjekti në ankim pretendon se vendimi i Komisionit, i cili referon nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është i gabuar, i pabazuar dhe në kapërcim të ligjit, pasi nga interpretimi gramatikor dhe logjik, lidhëza “dhe” e përdorur nga ligjvënësi, shteron mundësinë e përdorimit të pamjaftueshmërisë vetëm për një kriter, por kërkon që në rastin e pikës 3 të nenit 61 të jenë të lidhura në mënyrë të plotë ekzistenca e pamjaftueshmërisë së kontrollit të figurës dhe pamjaftueshmërisë së legjitimitetit të burimeve financiare të pasurisë. Trupi gjykues, bazuar në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 që, për konfirmimin në detyrë të subjektit, kërkon plotësimin së bashku të kushteve për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe aftësive profesionale, vlerëson se nëse subjekti nuk plotëson në mënyrë kumulative të tria kriteret e rivlerësimit, ndaj tij merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Sa i përket pretendimit të subjektit se parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 kërkojnë të lidhur në mënyrë të plotë ekzistencën e pamjaftueshmërisë së kontrollit të figurës dhe pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të pasurisë, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin tashmë të mbajtur nga Kolegji në vendimet⁴ e tij lidhur me këtë parashtrim, duke vlerësuar se nuk është e nevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarinimin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*
17. *Sa i përket pretendimit të subjektit se rastet e parashikuara nga ligji nr. 84/2016 për shkarkimin e gjyqtarit apo prokurorit, nuk janë parashikuar nga Kushtetuta, nuk janë autorizuar prej saj për t'u parashikuar me ligj, trupi gjykues vlerëson se parashikimet e nenit 61 të ligjit të posaçëm nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” janë në përputhje të plotë me dispozitat kushtetuese të parashikuara në nenet D, Dh, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës.*
18. *Subjekti në ankim pretendon se, bazuar në nenin D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar, pasi neni D i Aneksit të Kushtetutës, në pikën 5 parashikon: 5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Pra, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk jepet vetëm kur subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, të parashikuar në nenin D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, por dhe në rastet e tjera të parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pikat 2, 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.*
19. *Subjekti në ankim pretendon se Komisioni ka cenuar standardin për një proces të rregullt ligjor dhe ka shkelur parimin e barazisë së armëve. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se barazia e armëve juridike është një element i rëndësishëm në cilësimin e një procesi të rregullt ligjor, i cili*

⁴ Shih vendimet nr. 8, datë 16.04.2019, paragrafi 79; nr. 10, datë 19.11.2018, paragrafi 65 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

konsiston kryesisht në depozitimin e provave dhe në të drejtën për të kundërshtuar provat nëpërmjet argumenteve arsyetuese. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se ky pretendim nuk gjen vend në procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni, pasi subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia dhe i është garantuar e drejta e njohjes me provat e administruara nga Komisioni, e drejta e paraqitjes së provave nga subjekti, koha e mjaftueshme për të përgatitur prapësimet, si dhe informacioni i plotë lidhur me procesin e rivlerësimit⁵. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

20. *Për pretendimin se është shkelur e drejta për një proces gjykimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron pasi, bazuar në nenin 4 pika 5 e ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit ushtrojnë funksionet si institucione të pavarura dhe të paanshme⁶, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
21. *Sipas subjektit në ankim, Komisioni nuk ka respektuar parimin e kontradiktoritetit midis palëve në procesin e hetimit administrativ dhe atë të gjykimit në seancë dëgjimore, duke u dhënë vlerë vetëm dyshimeve të trupës së komisionerëve, pa marrë për bazë vlerën provuese të shpjegimeve dhe akteve të dorëzuara nga subjekti*. Trupi gjykues i Kolegjit, nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore, konstaton se Komisioni me vendimin nr. 2, datë 05.12.2018, vendos të njoftojë subjektin e rivlerësimit për mbylljen e hetimit paraprak, për kalimin e barrës së provës mbi rezultatet e hetimit, për t'u njohur me provat e administruara, si dhe mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar në adresën e tij elektronike (e-mail) për të paraqitur prova/shpjegime apo kërkesa mbi rezultatin e hetimit paraprak, si dhe me anë të korrespondencës elektronike ka përcjellë dokumentacion sqarues (e-mail të datës 14.12.2018). Nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 19.12.2018, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka marrë fjalën menjëherë pas prezantimit të përmbajtjes së dosjes së hetimit administrativ nga relatorja e çështjes, duke parashtruar të gjitha pretendimet e tij në mënyrë të hollësishme. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka respektuar parimin e kontradiktoritetit, të sanksionuar në nenin 18 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.
22. *Sa i përket pretendimit të subjektit se arsyetimi i vendimit nuk rezulton të ketë një analizë të provave dhe fakteve të administruara në proces, në funksion të një interpretimi që u duhej bërë normave kushtetuese dhe ligjore mbi të cilat bazohet vendimmarrja*, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në vendimin nr. 94, datë 21.12.2018, për secilën pasuri Komisioni ka analizuar provat e administruara gjatë hetimit administrativ, ka bërë arsyetimin ligjor dhe analizën e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm, konstatimet e rezultateve të hetimit,

⁵ - Vendimi nr. 2, datë 05.12.2018, i trupit gjykues të Komisionit, sipas së cilit subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; është njoftuar për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative;

- e-mail i datës 05.12.2018 "Njoftim për mbylljen e hetimit kryesisht", ku subjektit i vihet në dispozicion 10 ditë nga marrja e njoftimit për njohjen me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit, dhe paraqitjen e provave/shpjegimeve me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit;

- Vendimi nr. 3, datë 17.12.2018, i trupit gjykues të Komisionit, që fton subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

⁶ Shih paragrafin 67 të vendimit nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

pretendimet/prapësimet⁷ e subjektit dhe ka konkluduar bazuar në interpretim të drejtë të normave kushtetuese dhe ligjore.

23. Trupi gjykues i Kolegjit, sa i përket pretendimit të subjektit në ankim *se vendimi i Komisionit në faqen 3, pika 10, përcakton rrethana që nuk kanë lidhje me këtë proces rivlerësimi*, konstaton se ky përcaktim në vendimin e Komisionit nuk i referohet çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit Agron Vavla, por e cilëson këtë pasaktësi një gabim material, i cili nuk cenon vlefshmërinë e vendimit të Komisionit, si dhe rezultatin përfundimtar në vlerësimin e pasurisë së subjektit.
24. Subjekti në ankim *pretendon se arsyetimi i vendimit duhet të përmbajë një parashtrim të përmbledhur të rrethanave të faktit, provat mbi të cilat bazohen, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 66, datë 10.11.2017 dhe nr. 3, datë 20.01.2017). Mosplotësimi i këtyre kriterëve e bën vendimin të pavlefshëm*. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vendimi nr. 94, datë 21.12.2018, i Komisionit, në arsyetimin e tij rendit rrethanat e çështjes, faktet, provat, bazën ligjore mbi të cilën është bazuar procesi i rivlerësimit, vlerësimin e Komisionit në lidhje me hetimin administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit, analizën e provave të administruara për çdo pasuri, duke reflektuar prapësimet e subjektit, duke dhënë shpjegime në lidhje me kërkesat për provat e dorëzuara prej tij dhe duke konkluduar me caktimin e masës disiplinore, si përcaktuar në pikën 24 të këtij vendimi. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.
25. *Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me nenet 30, 31, 32 të ligjit nr. 84/2016, pasi objekti i veprimtarisë së tij është kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, dhe jo i saktësisë apo pasaktësisë së deklaratave të bëra në vite në ILDKPKI*. Trupi gjykues vlerëson se saktësia e të dhënave në deklaratat e interesave privatë dhe pasurorë ndër vite, është e rëndësishme, pasi këto deklaratat, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë nga Komisionit apo Kolegji i Apelit gjatë procesit të rivlerësimit. Pra, nëpërmjet analizës së këtyre deklaratave në harmoni me deklaratën e pasurisë *vetting*, konstatohet provueshmëria dhe ligjshmëria e pasurive, si dhe e burimeve të ligjshme financiare që kanë shërbyer për krijimin e tyre.
26. *Subjekti pretendon në ankim se vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, nenet 6, 7, 8, 13, 14 të KEDNj-së dhe protokollit shtesë të saj dhe se nga Komisioni janë shkelur të drejtat e njeriut për një proces të rregullt ligjor, si: e drejta e privatësisë familjare, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e drejta e mosndëshkimit pa faj, e drejta për një proces të pavarur*. Trupi gjykues i Kolegjit, në vijim të arsyetimit në pikat 12, 15, 19, 20 dhe 21 të këtij vendimi, konstaton se subjektit të rivlerësimit i është garantuar e drejta për një proces të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNj-së). Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka respektuar garancitë kushtetuese dhe parimet ndërkombëtare të mishëruara nga KEDNj-ja, që lidhen me barazinë përpara ligjit, kontradiktoritetin, mundësinë dhe kohën e nevojshme për t'u mbrojtur, parime që së bashku përbëjnë themelin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në kuptim të ligjit nr. 84/2016, garancitë që ofron neni 13 i KEDNj-së për një zgjidhje efektive të çdo shkeljeje të pretenduar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit i gëzon nëpërmjet paraqitjes së ankimit në Kolegji. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 2/2017,

⁷ Shih pikat 1.10.3, 2.30 e vijuese, 3.14 e vijuese, 4.16 e vijuese, 5.22 e vijuese të vendimit nr. 94, datë 21.12.2018, të Komisionit.

paragrafi 66, është shprehur se: *Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelimit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislativë dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).* Trupi gjykues vëren se subjekti në ankim nuk jep fakte konkrete të shkeljes së të drejtës së privatësisë familjare apo të të drejtave të tjera të sanksionuara në nenin 8 të KEDNj-së. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se vendimmarrja e Komisionit ka qenë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016 dhe pretendimi i subjektit është i pabazuar.

27. *Subjekti në ankim pretendon se hetimi administrativ, mënyra e ndërtimit të pyetjeve, oraret e dërgimit të tyre, koha e shkurtër në dispozicion për të paraqitur prova, për të dhënë shpjegime mbi faktet dhe rrethana të ndodhura vite më parë, kërkimi i të dhënave të panevojshme të familjarëve që mund të kenë lidhje me personat e lidhur me subjektin, tregojnë se qëllimi i Komisionit nuk ka qenë sqarimi i situatave të paqarta, por krijimi i një situatë stresi, gjendjeje ankthi, presioni për sigurinë dhe vazhdimësinë në detyrë, si dhe për të krijuar kurthe që vendosin subjektin në gabime njerëzore.* Trupi gjykues, në lidhje me këtë pretendim, çmon se ndërtimi i pyetjeve, koha e vënë në dispozicion nga Komisioni për të paraqitur prova e për të dhënë shpjegime gjatë hetimit administrativ, kanë qenë korrekte dhe në shërbim të sqarimit të rrethanave dhe fakteve lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit dhe personave të lidhur me të, si dhe nuk janë paraqitur nga subjekti të dhëna apo fakte mbi të cilat e mbështet këtë shkak ankimi. Sa sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.
28. *Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 49, pika 9 dhe nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi refuzimi i kërkesës së subjektit për marrjen dhe kërkimin e provës duhej të bëhej me vendim të arsyetuar,* trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i vendimit nr. 94, datë 21.12.2018, të Komisionit, vëren se në paragrafët 2.34 deri 2.38 të vendimit, Komisioni ka arsyetuar refuzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjektit të rivlerësimit nuk i është mohuar e drejta për t'u ankuar ndaj vendimit të Komisionit, duke pasur mundësinë ta bëjë këtë, së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar, sipas përcaktimit të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 470, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Arsyetimi i subjektit të rivlerësimit se bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me paraqitjen prej tij të shpjegimeve dhe provave të tjera, ezaurohet barra e provës për të, dhe nga ky moment barra i kalon përsëri Komisionit, nuk qëndron, pasi përcaktimet e ligjit nr. 84/2016 nuk parashikojnë kalimin e barrës së provës Komisionit.
29. *Subjekti në ankim e konsideron diskriminim ndaj tij faktin e vënies në dispozicion të afatit 10 ditë për t'u njohur me dokumentacionin e dosjes, për të bërë kërkesë për thirrje dëshmitari, marrjen e çdo prove mbështetëse, si dhe dhënien e shpjegimeve me shkrim për rezultatet e hetimit, ndërkohë që hetimi administrativ për Komisionin zgjati nga 15.01.2018 deri 05.12.2018.* Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i komunikimeve elektronike (me e-mail) ndërmjet Komisionit dhe subjektit, nuk konstaton kërkesë të subjektit të rivlerësimit për kohë shtesë në dispozicion, në përgjigje të rezultateve të hetimit. Subjekti i rivlerësimit ka marrë njoftim për rezultatet e hetimit më datë 06.12.2018 dhe ka dërguar shpjegimet e tij për të provuar të

kundërtën e këtyre rezultateve më 14.12.2018, përpara mbarimit të afatit prej 10 ditësh. Sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk është i bazuar.

30. *Subjekti në ankim pretendon se vendimi i Komisionit është në kundërshtim me vendimet të tjera të dhëna prej tij, duke mbajtur kështu qëndrim selektiv dhe diskriminues për subjektin në krahasim me subjekte që kanë kaluar me sukses kualifikimin, në shkelje të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollit respektiv.* Trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka arritur në konkluzione diskriminuese ndaj subjektit për shkaqe të tilla, si: gjinia, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, ose çdo status tjetër. Vendimet e Kolegjit, përveç shqyrtimit të vendimeve të marra nga Komisioni, kanë për qëllim garantimin e standardit të njëzuar në gjykimin e çështjeve, duke krijuar jurisprudencën dhe duke orientuar Komisionin. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbetet i paargumentuar, pasi ai nuk ka shpjeguar se mbi ç'bazë e ka diskriminuar Komisioni në krahasim me subjektet e tjera dhe pse konkluzioni i arritur prej tij në vendim përbën qëndrim selektiv dhe diskriminim lidhur me cilësitë individuale të subjektit, të mbrojtura nga neni 14 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
31. Trupi gjykues, referuar kërkesave të paraqitura në ankim nga subjekti i rivlerësimit, pasi analizoi shkaqet procedurale të ankimit, vlerësoi që shqyrtimi i çështjes gjyqësore të bëhet në dhomë këshillimi, mbi gjendjen e akteve të depozituara nga Komisioni, duke vlerësuar që nuk jemi përpara kërkesave të nenit 51, pika 1⁸ e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në prani të palëve.
32. Për arsyet e analizuara si më sipër, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

III/2. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shkaqet e ankimit

33. Subjekti i rivlerësimit Agron Vavla është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi {***} dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049”) dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë.
34. ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.01.2018, i ka dërguar Komisionit aktin e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Agron Vavla, në të cilin konkludon se:

⁸ Neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, parashikon: “[...] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me prani të palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendje faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsëritet marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë [...]”.

- i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Për pasurinë apartament me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 17,2 m², ndodhur në rr. “{}”, Tiranë***

35. Komisioni, në lidhje me këtë pasuri, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: i) ka paraqitur në mënyrë të pasaktë çmimin e këtij apartamenti në pronësi dhe ka fshehur çmimin real; ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti dhe garazhi në shumën prej -2.590.429 lekë; iii) ka kryer deklarim të rremë në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti, pasi nuk arriti të provojë se kishte të ardhura të ligjshme nga kursimet familjare; iv) ka kryer deklarim të rremë dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor provues në lidhje me të ardhurat e z. K.Sh., për të provuar mundësinë financiare nga burime të ligjshme të tij, për të dhënë këtë hua; v) ka kryer deklarim të rremë dhe ka mungesë burimi të ligjshëm financiar në deklaratën e pasurisë “vetting”, për shumën 1.580.000 lekë, për apartamentin me sip. 110,8 m², në rr. “{***}”, në Tiranë, në vitin 2015.
36. Trupi gjykues konstaton se kjo pasuri, apartament me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 17,2 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, është në pronësi të subjektit të rivlerësimit Agron Vavla, konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 16.02.2018, të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.
37. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015 si vijon:
*Blerje apartamenti, shtuar, sipas kontratës noteriale të shitjes së pasurisë së paluajtshme me numër {***}, datë 19.05.2015, sipërfaqja totale 110,8 m², numër pasurisë {***}, Tiranë. Burimi: Nga gjendja CASH (arka në shtëpi). Në vlerën 42.280 euro.*
*Blerje garazhi, shtuar, sipas kontratës noteriale të shitjes së pasurisë së paluajtshme me numër {***}, datë 19.05.2015, sipërfaqja totale 17,2 m², numri i pasurisë {***}, Tiranë. Burimi: Nga gjendja CASH (arka në shtëpi). Në vlerën 4.000 euro.*
 Në deklaratën e pasurisë vetting 2017, subjekti deklaroi:
*Apartament banimi me numër pasurie {***}, vol {***}, faqe {***}, zona kadastrale {***}, sipërfaqe 110,80 m², rruga “{***}”, Tiranë, viti i krijimit 19.05.2015, sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., blerë nga znj. F.Gj. në shumën 42.280 euro, kursi i këmbimit 140 lekë/euro.*
*Burimi: Të ardhurat familjare; kontratë huadhënieje nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 02.09.2008, në shumën 30.000 euro*. Në shumën 5919200 lekë.
*Garazh me numër pasurie {***}, vol {***}, faqe {***}, zona kadastrale {***}, sipërfaqe totale 17,20 m², rruga “{***}”, Tiranë, viti i krijimit 19.05.2015, sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., blerë nga F.Gj. në shumën 4.000 euro, me kursin 140 lekë/euro.*
*Burimi: Të ardhurat familjare; kontratë huadhënieje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2008, në shumën 30.000 euro.* Në shumën 560.000 lekë.

38. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se si burim krijimi për këto pasuri, në vitin 2015, subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* (arka në shtëpi), ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, për këto pasuri ka deklaruar si burim krijimi *të ardhurat familjare dhe kontratë huadhënie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2008, në shumën 30000 euro*. Subjekti nuk ka deklaruar të njëjtin burim krijimi për këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting* me burimin e deklaruar në deklaratën periodike.
39. Subjekti pretendon në ankim se në vitin 2015, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 110,8 m², garazhit me sipërfaqe 17,2 m², në rr. “{***}”, si dhe për një pjesë të arredimit, ka përdorur mjetet financiare në euro që kanë qenë gjendje *cash* në fillim të vitit, datë 01.01.2015, në vlerën 54.125 euro, llogari e cila më 31.12.2015 është në vlerën zero euro. Burim i krijimit të shumës 54.125 euro, *gjendje cash vjen nga viti 2012, nga zgjidhja e kontratës së porosisë dhe kthimit të shumës 46625 euro*, si dhe shtuar gjendja në euro në shumën 7500 në vitin 2014, pra gjendja më datë 31.12.2014, në *cash*, është 54.125 euro.
40. Lidhur me pretendimin e subjektit në ankim, se si burim krijimi ka shërbyer gjendja *cash* në vitin 2012, nga zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes dhe kthimi i shumës 46.625 euro, nga analiza e dokumentacionit në dosjen gjyqësore, në lidhje me këtë burim, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit deklaron: *shtuar sipërfaqe banimi 127,5 m², e paregjistruar në ZRPP, sipas kontratës së sipërmarrjes noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.08.2008, në shumën e likuiduar 44.625 euro*. Kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.08.2008, nënshkruhet nga porositi Agron Vavla dhe sipërmarrësi shoqëria “{***}” ShPK, për një apartament me sipërfaqe totale 127,5 m², të ndodhur në fshatin {***}, Linzë, Tiranë, në vlerën 44.625 euro, *likuiduar tërësisht para përpilimit të kësaj kontrate*. Për arsye të mosplotësimit të detyrimeve kontraktore nga pala sipërmarrëse, shoqëria “{***}” ShPK, palët nënshkruajnë “Zgjidhje kontrate porosisë” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.03.2012, me anë të së cilës shoqëria “{***}” ShPK i kthen Agron Vavlës të gjithë shumën e paguar për porositjen e apartamentit, në vlerën 44.625 euro, dhe një shumë prej 2.000 eurosh si sanksion për mosrealizimin e kontratës së shitjes. Ky fakt deklarohet nga subjekti në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, si vijon: *Shtuar në euro, sipas zgjidhjes së kontratës së porosisë me numër {***} rep., {***} kol., datë 24.03.2012. U zgjidh kontrata e porosisë me nr. {***} rep., {***} kol., datë 13.08.2008 dhe palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme dhe 2.000 euro si penalitet për mosrealizimin e kontratës së porosisë [...], në vlerën 46.625 euro*.
41. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se si burim krijimi i shumës 44.625 euro në vitin 2008, ka shërbyer shuma e marrë hua, 30.000 euro, sipas kontratës së huadhënies nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2008, e nënshkruar mes z. K.Sh., si huadhënës, dhe bashkëshortes së subjektit, znj. F.V., si dhe depozita e subjektit në Procredit Bank, më datë 10.09.2008, në vlerën 14.280 euro, vlerë e krijuar ndër vite, nga gjendja *cash* në shtëpi në vlerën 600.000 lekë dhe depozita në ProCredit Bank në shumën 800 euro deri në datën 31.12.2002, dhe të ardhurat familjare në vitet 2003-2008.
42. Trupi gjykues vlerëson se në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, nuk rezulton të jetë deklaruar gjendje në *cash* e mbartur nga viti 2002 në vlerën prej 600.000 lekësh. Duke qenë se kjo vlerë nuk është deklaruar nga subjekti, me të drejtë nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, ka pasur detyrimin të dorëzojë deklaratën e pasurisë për herë të parë, bazuar në nenin 6 të këtij ligji që me

hyrjen e tij në fuqi, në maj 2003. Detyrimi i subjektit ka qenë të deklarojë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre. Në formularin A-5 të deklaratës së parë të vitit 2003 përcaktohej deklarimi i likuiditeteve, duke specifikuar gjendjen në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie.

43. Në vijim, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se tipi i deklarimit në vitin 2003 nuk ka qenë “për herë të parë” por “vjetor”, nuk qëndron pasi si subjekt deklarues ka qenë i detyruar nga neni 3, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, në vitin 2003, të deklaronte bazuar në nenin 6 të këtij ligji, të gjitha pasuritë e akumuluar deri më 31 dhjetor 2003, dhe jo vetëm shtimin apo pakësimin e ndodhur gjatë vitit 2003. Bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, përcaktohen si të ardhura të ligjshme ato të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në mungesë të deklarimit në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 të gjendjes *cash* nga subjekti, nuk mund të merret në konsideratë kjo shumë.
44. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit në ankim se në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004 janë bërë korrigjime dhe është deklaruar për herë të parë gjendja e pasurisë së mbartur deri në datën 31.12.2002, gjendja në *cash* në shtëpi, në shumën 600.000 lekë, dhe gjendja në bankë, në shumën 800 euro, nuk qëndron. Nëse i referohemi deklaratës së interesave privatë të vitit 2004, rezulton e deklaruar nga subjekti, në rubrikën “Informacion konfidencial”, pasuri e luajtshme 320.000 lekë + 3.600 euro në ProCredit Bank, Berat, por nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie, pra nuk është saktësuar nga subjekti që kjo shumë ka burim krijimi gjendjen *cash* prej 600.000 lekësh. Ndërsa sa i përket shumës 800 euro, nga analiza e balancave të llogarive të subjektit dhe personave të lidhur me të, në Bankën Procredit ShA, nga të dhënat e përcjella nga kjo bankë me shkresën nr. {***} prot., datë 04.05.2018, nuk rezulton që subjekti dhe personat e lidhur të kenë pasur gjendje likuiditetesh në këtë bankë më 31.12.2003.
45. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2004, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të krijuar dy depozitat, prej 320.000 lekësh + 3.600 eurosh, në ProCredit Bank, në vlerën -783.727 lekë.
46. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare nga të ardhurat e ligjshme për të justifikuar vlerën prej 14.625 eurosh, që ka shërbyer për likuidimin e çmimit të apartamentit të ndodhur në {***}, sipas kontratës së sipërmarrjes noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.08.2008, në shumën e likuiduar 44.625 euro, e më tej dhe për apartamentin dhe garazhin e ndodhur në rr. “{***}”, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
47. Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga kontrata e huadhënies, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kontrata e huadhënies nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2008, e nënshkruar mes z. K.Sh., si huadhënës dhe bashkëshortes së subjektit, znj. F.V., në cilësinë e huamarrëses, është deklaruar për herë të parë nga subjekti rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, si *kontratë huadhënieje me nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 2.09.2008, në shumën 30.000 euro, me interes 2% në vit, me afat shlyerjeje deri më datë 02.09.2018, me qëllim shtimin e sipërfaqes së banimit, sipas kontratës së sipërmarrjes*. Nga analizimi i datës së nënshkrimit të kontratës së huadhënies dhe kontratës së sipërmarrjes, duke sjellë në vëmendje që kontrata e huadhënies, në të cilën përcaktohet se shuma e huas prej 30.000 eurosh është dhënë ditën e nënshkrimit të kontratës, më 02.09.2008, dhe kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}”

ShPK, në të cilën përcaktohet se vlera 44.625 euro e apartamentit është *likuiduar tërësisht para përpilimit të kësaj kontrate*, pra përpara datës 13.08.2008, trupi gjykues konstaton se shumta e huas në vlerën 30000 euro, nuk mund të ketë shërbyer për pagesën e vlerës së apartamentit në {***}, Linzë. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se zhvendosja në kohë e pagesës së kryer për apartamentin në {***} dhe kohës kur është përpiluar kontrata e huadhënies, të krijojnë bindjen se vlera e apartamentit ka qenë likuiduar me burime të tjera financiare të subjektit, nga të ardhura të pajustificuara dhe jo me shumën e marrë hua. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, në lidhje me burimin e krijimit të apartamentit të ndodhur në {***} e për pasojë, dhe deklarimi i tij në deklaratën e pasurisë *vetting* për burimin e krijimit të apartamentit me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazhit me sipërfaqe 17,2 m² të ndodhur në rr. “{***}” Tiranë, rezulton i rremë, sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

48. Në vijim të arsytimit mbi të ardhurat nga kontrata e huadhënies, trupi gjykues i Kolegjit së pari vlerëson se kjo marrëdhënie detyrimi i jep shtetasit K.Sh. cilësinë e personit tjetër të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës person tjetër i lidhur është personi fizik apo juridik që duket se ka apo ka pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Sa më sipër, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se: *4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, dhe të pikës 19 të udhëzimit nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së: Nëse personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit deklarojnë një marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit, detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të provuar mundësinë financiare të z. K.Sh., nga të ardhura të ligjshme për dhënien e huas në vlerën 30000 euro.*
49. Trupi gjykues, nga analizimi i dokumenteve të depozituara nga subjekti për të ardhurat e z. K.Sh. nga punësimi në Itali, vlerëson se CUD⁹ 2003, 2005, 2006, 2007, 2008, çmon se ato nuk përmbushin kërkesat e neneve 246¹⁰ dhe 266 të Kodit të Procedurës Civile¹¹ për t’u konsideruar në cilësinë e provës, pasi janë depozituar nga subjekti në gjuhën italiane, të papërkthyer, të panoterizuara, të palegalizuara, si dhe të palexueshme në disa raste, duke e bërë të vështirë identifikimin e të dhënave në to. Ndërsa sa u përket CUD 2012, 2013, 2014 dhe 2015, përveç faktit që nuk janë sipas formës së kërkuar nga neni 266 i Kodit të Procedurës Civile, ato u përkasin të ardhurave për periudhën pas nënshkrimit të kontratës së huadhënies dhe, për rrjedhojë, nuk provojnë mundësinë financiare të z. K.Sh. për dhënien e huas. Sa i përket dokumentit të lëshuar nga punëdhënësi i z. K.Sh., kompania “{***}”, më datë 13.12.2018, në të

⁹ CUD = akronim për *Certificato Unico Dipendente*.

¹⁰ Neni 246 i Kodit të Procedurës Civile: “Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishtje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen”.

¹¹ Kodi i Procedurës Civile në nenin 266 përcakton: “[...] Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent. Kur gjykata nuk mund ta kontrollojë vetë saktësinë e përkthimit, emëron përkthyes”.

përcaktohet se huadhënësi është i punësuar pranë kësaj kompanie që prej datës 07.01.2002 e në vijim me kontratë me afat të pacaktuar, por nuk ka asnjë të dhënë për të ardhurat financiare/pagën etj. Në mbështetje të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion justifikues ligjor burimet financiare nga të ardhura të ligjshme të z. K.Sh. për dhënien e huas prej 30.000 eurosh në vitin 2008.

50. Në praktikën e huadhënies dhe shlyerjes së pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, asnjë veprim financiar nuk është kryer nëpërmjet transfertave bankare apo ndonjë dokumenti tjetër provues financiar. Pretendimi i subjektit se shuma e huas është transferuar nga Italia në Shqipëri sa herë huadhënësi ka ardhur në Shqipëri dhe shlyerja e këtij detyrimi nga huamarrësi kryhet prapë në *cash* kur huadhënësi vjen në Shqipëri gjatë pushimeve të verës, siç është deklaruar gjatë seancës dëgjimore, nuk është bindës për trupin gjykues.
51. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk analizoi si provë kontratën e huas, vlefshmërinë e saj, sistemin TIMS për periudhën e qenies së z. K.Sh. në Shqipëri apo mundësinë e kalimit në pikën kufitare të shumës *cash* së lejuar. Trupi gjykues i Kolegjit, përveç sa arsyetuar më sipër, konstaton se Komisioni¹², me anë të sistemit TIMS¹³, ka provuar se huadhënësi K.Sh. nuk ka qenë në Shqipëri në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe dhënies së huas më datë 02.09.2008. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.12.2018, depozituar në Komision nga vetë subjekti, rezulton se huadhënësi K.Sh. nuk ka qenë në Shqipëri më datë 02.09.2008, ditën e nënshkrimit të kontratës dhe të dhënies së huas. Referuar kësaj shkrese, K.Sh. ka hyrë në Republikën e Shqipërisë më datë 25.08.2018 dhe ka dalë më datë 28.08.2018, me linjën {***} Durrës - Bari, pra 5 përpara nënshkrimit të kontratës, më datë 02.09.2008.
- Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se shkresa nr. {***} prot., datë 07.12.2018, e lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Berat, ka të dhëna të pabesueshme, kontradiktore të sistemit TIMS për z. K.Sh., nga viti 2005 deri në vitin 2018. Nga analizimi i të dhënave të kësaj shkrese, rezulton se pretendimet e subjektit për pasaktësi nuk korrespondojnë me datën e nënshkrimit të kontratës së huadhënies më 02.09.2008. Sipas shkresës, K.Sh. rezulton të ketë dalë nga pika kufitare Durrës më 28.08.2008 dhe të ketë hyrë në Shqipëri më datë 02.10.2008, ndërkohë që subjekti edhe pse pretendon që K.Sh. ka qenë prezent në momentin e nënshkrimit të kontratës së huas, nuk depozitoi dokumentacion ligjor për të provuar këtë fakt.
52. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit kërkoi thirrjen si dëshmitar të z. K.Sh., si dhe kryerjen e ekspertimit të nënshkrimit të tij në kontratën e huadhënies. Komisioni, në zbatim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ka refuzuar¹⁴ këtë kërkesë, duke e konsideruar të panevojshme, pasi provimi i qenies prezent në momentin e nënshkrimit të kontratës, është veprim juridik që kërkon dokument shkresor, sipas parashikimit të nenit 231 të Kodit të Procedurës Civile. Ndërsa për sa i përket kërkesës për kryerjen e ekspertimit për të vërtetuar nënshkrimin e huadhënësit në kontratë, Komisioni e konsideroi të panevojshme dhe me qëllim zvarritjen e procesit.
53. Subjekti i rivlerësimit në ankim parashtron përsëri këto kërkesa, duke pretenduar se neni 234 i Kodit të Procedurës Civile lejon të merret prova me dëshmitarë, pasi në rastin konkret Komisioni

¹² Shih pikën 2.27 të vendimit nr. 94, datë 21.12.2018.

¹³ TIMS – akronim për Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit.

¹⁴ Shih paragrafin 2.38 të vendimit nr. 94, datë 21.12.2018.

ka pretenduar se z. K.Sh. nuk ka qenë prezent datën e nënshkrimit të kontratës, pra pretendohet se veprimi juridik është kryer vetëm në dukje, pa pasur qëllim që palët të krijojnë pasoja juridike.

54. Në kuptim të nenit 234 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *Kundër ose tej përmbajtjes së një veprimi juridik të bërë me shkresë, personi i tretë është i lirë në paraqitjen e provave. Kur njëra prej palëve kontraktuese pretendon se veprimi juridik është kryer vetëm në dukje, pa pasur qëllim që palët të krijojnë pasoja juridike, ose për të mbuluar një veprim tjetër juridik, të cilin palët e kanë dashur, prova me dëshmitarë lejohet në rastet kur ka provë me shkresë të lëshuar nga pala tjetër ose deklarime të bëra prej kësaj përpara institucioneve shtetërore, nga të cilat bëhet e besueshme se veprimi juridik është kryer vetëm për dukje, trupi gjykues i Kolegjit çmon se parashikimet ligjore në këtë dispozitë nuk mbështetin kërkesën e subjektit për marrjen e provës me dëshmitarë, pasi sipas këtyre parashikimeve legjitimohen për të kërkuar provë me dëshmitarë vetëm palët kontraktuese në një veprim juridik, në rast se ato ngrenë pretendim kundër njëra-tjetrës mbi një veprim juridik të kryer prej tyre. Trupi gjykues, në lidhje me këtë shkak ankimi, vlerëson se për të vërtetuar praninë e z. K.Sh. ditën e nënshkrimit të kontratës së huadhënies para noterit, kërkohet provë shkresore, duke çmuar kështu të drejtë qëndrimin e mbajtur nga Komisioni.*
55. Referuar aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 10.01.2018¹⁵, ky institucion ka arritur në konkluzionin se: *Mungon burimi i ligjshëm financiar dhe deklarim i rremë, në lidhje me huamarrjen në shumën 30.000 euro, në vitin 2008, nga nipi i b/shortes, emigrant në Itali, për apartamentin në rr. “{***}”, Tiranë, pasi transaksionet janë në rrugë informale, në cash dhe pa deklarim në kufi. Komisioni në vijim, në përfundim të hetimit administrativ, ka arritur në konkluzionin se: *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor provues në lidhje me të ardhurat e z. K.Sh., për të provuar mundësinë financiare dhe burime të ligjshme të tij për të dhënë këtë hua, ndërkohë që nga ana tjetër, në analizën financiare të kryer, ka marrë në konsideratë shumën e përcaktuar në kontratën e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2008.**
- Trupi gjykues në Kolegji, ndryshe nga qëndrimi i Komisionit, vlerëson se kur subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të rremë në bazë të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë dokumentacioni provues ligjor në lidhje me të ardhurat e huadhënësit, atëherë nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme dhe përfshihet në analizën financiare shuma e përfituar nga kontrata e huadhënies.
56. Lidhur me gjendjen në euro në shumën 7.500, të shtuar në vitin 2014, që ka shërbyer si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazhin me sipërfaqe 17,2 m², nga analiza financiare e kryer në Kolegji, rezulton se për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 2.257.184 lekë.
57. Në mbështetje të sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk justifikojnë kursimet për periudhën 2003-2008 dhe për vitin 2014, që sipas subjektit kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazhin me sipërfaqe 17,2 m², sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

¹⁵ Shkresë nr. {***} prot., datë 10.01.2018, e ILDKPKI-së: “Dërgohet akti i kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Agron Vavla me funksion Gjyqtar/Kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat”.

58. *Lidhur me pretendimin e subjektit në ankim se Tabela nr. 1, “Analiza financiare për vitin 2015”, në vendimin e Komisionit nuk përmban ekstremitetet, shpjegimet për të dhënat e pasqyruara, si dhe nuk pasqyron me vërtetësi gjendjen e shifrave, sipas deklaratës “vetting” apo deklaratës së interesave privatë/periodikë të vitit 2015, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në të janë pasqyruar të dhënat e pasurive, të ardhurave, detyrimeve financiare dhe shpenzimeve të kryera sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting dhe deklaratat periodike të provuara me dokumentacion justifikues ligjor. Mungesa e ekstremiteve apo shpjegimeve në tabelë është plotësuar me shpjegimet e dhëna për analizën financiare subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, me kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të cilat subjekti ka parashtruar shpjegime dhe ka paraqitur aktekspertimin. Mungesa e ekstremiteve në tabelë nuk sjell për pasojë ndryshimin e rezultatit të analizës financiare të kryer.*
59. *Për sa i përket gjendjes cash në banesë të pretenduar nga subjekti si të pandryshuar prej datës 24.03.2012 deri në maj të vitit 2015, në shumën 46.625 euro, nga analizimi i deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nga viti 2012 deri në vitin 2015, trupi gjykues konstaton që gjendja cash në banesë të ketë ndryshuar si vijon, shtuar 44.625 euro nga revokimi i kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.08.2008, më datë 24.03.2012, me “Zgjidhje kontrate porosie” nr. {***} rep., nr. {***} kol., shtuar 2000 euro si sanksion i përfituar për mosrealizimin nga sipërmarrësi të kontratës së shitjes, shtuar 3000 euro nga shitja e automjetit me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2012, dhe pakësuar 10.000 euro për automjetin e blerë në Gjermani, BMW, X3. Nga përlllogaritjet e kryera, bazuar në deklaratimet më sipër, gjendja cash në shtëpi rezulton të jetë 39.625 euro dhe jo 46.625 euro, sa pretendon subjekti i rivlerësimit.*
60. *Sipas subjektit të rivlerësimit në ankim, gjendja e likuiditeteve në euro, më datë 31.12.2014, është në vlerën 54.125 euro, të deklaruara prej tij në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, ndërsa nga analizimi i shtesave dhe pakësimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e e interesave privatë të viteve 2012-2015, gjendja në euro në fund të vitit 2014 rezulton të jetë 44.125 euro. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2013, subjekti deklaron: “vazhdon gjendja cash prej 43.000 eurosh”; në po këtë deklaratë deklaron: “pakësuar me 3.000 euro nga gjendja cash 43.000 euro, si detyrim për studimet e djalit”, për rrjedhojë gjendja cash në fund të vitit 2013 është 36.625 euro, sipas përlllogaritjeve të kryera në paragrafin më sipër. Në deklaratën e interesave privatë 2014, subjekti deklaron vazhdon gjendje cash jashtë sistemit bankar si rezultat i “Zgjidhje kontrate porosie” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.03.2012, në vlerën 40.000 euro dhe në vijim deklaron gjendje cash jashtë sistemit bankar mbetur pa u konsumuar nga të ardhurat e fituara si familje për vitin 2014, në vlerën 7.500 euro. Sipas pretendimeve të subjektit, gjendja cash ishte 47.500 euro. Në vijim të përlllogaritjeve të kryera në Kolegj, bazuar në deklaratimet e vetë subjektit, gjendja cash në fund të vitit 2014 do të rezultonte 36.625 euro + 7.500 euro – në vlerën 44.125 euro – dhe jo sa pretendon subjekti. Nga analiza e kryer si më sipër, arrihet në konkluzionin se pretendimi i subjektit se gjendja cash prej datës 24.03.2012 deri në maj të vitit 2015, mbetet e pandryshuar, në shumën 46.625 euro, nuk qëndron.*
61. *Subjekti pretendon në ankim se Komisioni ka gabuar në qëndrimin e mbajtur se [...] çmimi i apartamentit të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, blerë në vitin 2015, i përfunduar nuk mund të jetë afërsisht sa një apartament i papërfunduar në {***}, Tiranë. Subjekti nuk arriti të shpjegojë*

*bindshëm dhe të provojë se çmimi prej 44280 eurosh që ka paguar për apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, të përfunduar në vitin 2015, nuk ishte i lirë apo preferencial, dhe se veprimet juridike për pasuritë e paluajtshme janë noteriale, të nënshkruara me vullnetin e lirë të palëve dhe Komisioni duhet t’i kishte çmuar si provë të plotë.*

Trupi gjykues, nisur nga viti i kryerjes së transaksioneve, vendndodhjes së apartamenteve respektive, statusin e tyre (përfunduar/papërfunduar) dhe çmimin respektiv, konstaton se blerja në vitin 2008 e apartamentit me sipërfaqe 127,5 m² në {***}, Linzë, zonë periferike, në vlerën 44.625 euro ende i papërfunduar ka pothuajse të njëjtën vlerë me apartamentin me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazhin me sipërfaqe 17,2 m², blerë 7 vjet më vonë, në vitin 2015, në rr. “{***}”, Tiranë, në vlerën 42.280 euro, të përfunduar. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm se pse vlera e paguar për apartamentin në vitin 2015 nuk ishte nën vlerën mesatare të tregut apo preferencial.

62. Për të provuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të justifikuar me të ardhura nga burime financiare të ligjshme krijimin e pasurisë apartament, me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 17,2 m², të ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, që sipas kontratave¹⁶ respektive të shitjes, janë likuiduar më datë 15.05.2015, përkatësisht në vlerën 42.280 euro dhe 4.000 euro, u krye analiza financiare në Kolegj për periudhën 01.01.2015 – 15.05.2015, bazuar në të dhënat e dokumentacionit justifikues ligjor të administruar dhe në vlerësimin ligjor. Rezultatet e analizës treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 4.489.462 lekë, pa konsideruar në përlllogaritje shumën e huas prej 30.000 eurosh, të pretenduar nga kontrata e huadhënies nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2008. Në konsideratë të faktit që nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2014, ka rezultuar që subjekti dhe personat e lidhur nuk justifikojnë me të ardhura nga burime të ligjshme shumën prej 7.500 eurosh, të deklaruar si kursim në deklaratën e interesave privatë të vitit 2014, si shpjeguar më sipër, pamjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme për likuidimin e çmimit prej 46.280 eurosh për blerjen e apartamentit dhe garazhit më datë 15.05.2015, rezulton në vlerën - 6.480.309 lekë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
63. Subjekti pretendon në ankim se Komisioni ka gabuar në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë burimi financiar të ligjshëm, në deklaratën e pasurisë *vetting*, për vlerën 1.580.000 lekë. Komisioni nuk është shprehur qartë, si dhe nuk ka mundur të interpretojë dhe të sqarojë se çfarë përfaqëson kjo shumë. Në pikën 2.11 të vendimit, Komisioni ka konstatuar se *në deklaramin vjetor të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit deklaronte shpenzime të kryera në shumën prej 1.584.000 lekësh, për mobilimin e apartamentit me sipërfaqe 110,8 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, në vitin 2015, por nuk ka dhënë shpjegime apo të ketë arsyetuar për parregullsi të shpenzimeve për mobilimin e shtëpisë.*
64. Lidhur me pretendimet më sipër, bazuar në sa deklaronte subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2015 se shpenzimet *për mobilim, blerje pajisjesh të luajtshme për arredimin e apartamentit* në vlerën 4.245 euro (ose 580.000 lekë, konvertuar me kursin mesatar të këmbimit për vitin 2015) dhe 1.000.000 lekë, si dhe faktin që subjekti i

¹⁶ *Kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.05.2015, për apartamentin me sipërfaqe 110,8 m²; kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.05.2015, për garazhin me sipërfaqe 17,2 m².*

rivlerësimi nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor ku të specifikohet data/muaji i kryerjes së pagesave për arredim, u krye analiza financiare në Kolegj, për periudhën 16.05.2015 - 31.12.2015, nga ku rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera në këtë vit, përfshirë arredimin, në vlerën 2869434 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të gjithë sa arsyetuar më sipër, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 17,2 m², trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, gjerat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.

65. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie u bazua në aktet si më poshtë.
- i. Deklarata e pasurisë “vetting” 2017, e dorëzuar pranë ILDKPKI-së dhe dokumentacioni shoqërues.
 - ii. Deklaratat e interesave privatë të viteve 2003 – 2015.
 - iii. Kontratë huadhënieje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2008, nënshkruar mes znj. F.V. dhe z. K.Sh.
 - iv. CUD (Certificato Unico Dipendente, format standard i lëshuar nga INPS (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore të shtetit italian), vitet 2003, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2013, 2014, 2015 të z. K.Sh.
 - v. Shkresa nr. {***} prot., datë 07.12.2018, e Drejtorisë Vendore të Policisë Berat.
 - vi. Dokument i lëshuar nga punëdhënësi i z. K.Sh., Kompania {***}.
 - vii. Kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.08.2008, me shoqërinë “{***}” ShPK.
 - viii. Zgjidhje kontrate nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.03.2012, me shoqërinë “{***}” ShPK.
 - ix. Shkresa nr. {***} prot., datë 16.02.2018, ZVRPP Tiranë, me dokumentacionin shoqërues.
 - x. Kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.05.2015, për apartamentin me sipërfaqe 110,8 m².
 - xi. Kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.05.2015, për garazhin me sipërfaqe 17,2 m².
 - xii. Akt ekspertimi, B.Ç., person fizik, licenca nr. {***}, datë 26.02.2005, NIPT: {***}.
 - xiii. Dokumentacioni i përcjellë nga bankat e nivelit të dytë.
 - xiv. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

Për pasurinë automjet BMW, X3

66. Komisioni, për këtë pasuri, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: *i) ka paraqitur në mënyrë të pasaktë çmimin e blerjes së këtij automjeti pasi nuk provoi me dokumentacion ligjor se çmimi i blerjes së këtij automjeti ishte në vlerën 10.000 euro; ii) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar blerjen e këtij automjeti në vitin 2012, një diferencë me minus në vlerën prej 141495 lekësh.*
67. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo pasuri e luajtshme është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012: *[...]Automjeti është blerë personalisht në Gjermani, në shumën 10000 euro. Më pas janë paguar taksat, si 20% të vlerës*

së blerjes në shumën 280.000 lekë, taksat përkatëse dhe është targuar {***}. Bashkëlidhur dhe dokumentacioni përkatës. Në deklaratën e këtij viti nuk është përcaktuar nga subjekti i rivlerësimit burimi i krijimit të kësaj pasurie.

68. Në deklaratën e pasurisë vetting 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Automjeti, marka X3, blerë në Gjermani në datën 26.11.2012, në shumën 10.000 euro, me kursin e këmbimit 140 lekë/euro, paguar dogana në shumën 280.000 lekë, me targë {***}. Burimi: të ardhurat familjare, si dhe të ardhura nga shitja e automjetit me targë {***}, sipas kontratës shitje-blerje automjeti, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2012, në shumën 3.000 euro, me kurs 140 lekë/euro. Në vlerën 1.680.000 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting, subjekti nuk ka depozituar dokumentin ligjor për fitimin e këtij automjeti (kontratë shitje/faturë), sipas parashikimit të nenit 32, pika 1¹⁷ e ligjit nr. 84/2016.*
69. *Subjekti në ankim pretendon se Komisioni ka gabuar në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë çmimin e blerjes së automjetit, pasi në interpretim të provave të administruara, akteve të dosjes së zhdoganimit të automjetit, paraqitur si provë nga subjekti, provohet e kundërta.*
70. Trupi gjykues i Kolegjit, në lidhje me këtë pretendim, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, konstaton se:
- Në kopjen e dosjes së automjetit me targë {***}, të përcjellë nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë me shkresën nr. {***} prot., datë 07.02.2018, në dokumentin “Kërkesë për regjistrim për herë të parë të mjetit rrugor”, zëri “Dokument i fitimit të pronësisë” është përcaktuar kontratë e huaj, ndërkohë që kopja e kontratës nuk ndodhet në dosjen e këtij automjeti.
 - Në praktikën doganore të këtij automjeti, përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Dega Doganore Berat me shkresën nr. {***} prot., datë 11.12.2018, nuk është dërguar kontrata e huaj e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.
 - Në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, subjekti deklaroi: *në momentin e zhdoganimit të mjetit, autoriteti doganor nuk merrte në konsideratë faturën e origjinës së mallit (kontratën e shitjes së mjetit apo faturën tatimore të ardhur nga Gjermania, por ka kryer vlerësimin e mjetit nëpërmjet procedurës së referencës doganore [...]. Pavarësisht vlerësimit doganor, mjeti është blerë në Gjermani në shumën 10.000 euro. Meqenëse nuk më është kërkuar kontrata e shitjes së mjetit në Gjermani nga administrata doganore, nuk kisha arsye pse ta mbaja këtë dokument më pas.*
 - Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka deklaruar se ka pasur një kontratë shitjeje, për blerjen e automjetit, por nuk kishte detyrimin ligjor ta mbante, pasi me zhdoganimin dhe pagimin e detyrimeve, automjeti është një mjet i ligjshëm në qarkullim civil.
 - Në ankim subjekti sqaron se në momentin e zhdoganimit të mjetit, autoriteti doganor nuk ka marrë në konsideratë faturën e origjinës së mallit (kontratën e shitblerjes së mjetit apo faturën tatimore të ardhur nga Gjermania), por ka kryer vlerësimin e mjetit nëpërmjet procedurës së referencës doganore, për të cilën ka nxjerrë dokumentin administrativ të vlerësimit (DAV).

¹⁷ Neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

71. Bazuar në nenet 34, 35 dhe 36 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”¹⁸, i ndryshuar, i cili ka qenë në fuqi në momentin e zhdoganimit të automjetit të subjektit të rivlerësimit, vlera doganore e mallrave të importuara përcaktohet së pari nga 1) vlera e transaktuar, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat dhe nëse kjo nuk mund të përcaktohet, vlera doganore përcaktohet sipas radhës; 2) vlera e transaktuar e mallrave identike të shitura; 3) vlera e transaktuar e mallrave të ngjashme; 4) vlera e bazuar në çmimin për njësi; 5) vlera e përlogaritur nga kosto ose vlera e materialeve e fabrikimit. Nëse nuk përcaktohet sipas vlerave më sipër, përcaktohet 6) në bazë të të dhënave të disponueshme në Republikën e Shqipërisë.
72. Sipas pretendimit të subjektit, në Kodin Doganor rezultojnë gjashtë metoda vlerësimi dhe në këtë rast është përdorur metoda e gjashtë që konsiston në referencë doganore dhe jo transaksion apo kontratë shitjeje. Si cituar në paragrafin më sipër, vlera doganore së pari përcaktohet me vlerën e transaksionit, çmimin real të paguar dhe vetëm nëse kjo nuk pranohet, vijohet duke respektuar radhën me metodat e tjera. Në kuptim të dispozitave të sipërcituara, fatura apo kontrata e shitjes kërkohen gjithmonë nga autoritetet doganore pasi aty përcaktohet vlera e transaksionit, çmimi realisht i paguar.
- Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se autoritetet doganore përdorin referencën në ato raste kur nuk pranohet vlera e transaksionit sipas kontratës, dhe për këtë fakt importuesi i mjetit informohet nga autoritetet doganore. Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk sqaroi se përse nuk iu pranua nga autoritetet doganore kontrata e shitblerjes që ai dispononte, si dhe vlera e përcaktuar në kontratën e depozituar prej tij.
73. Trupi gjykues vlerëson që pretendimi i subjektit se nuk ka pasur detyrimin të mbajë kontratën e huaj për blerjen e automjetit, nuk është i bazuar, pasi në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë pasuritë që prej vitit 2003, me hyrjen në fuqi të këtij ligji e në vazhdim. Në zbatim të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, *subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të së bashku me deklaratën e pasurisë paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Detyrimi i paraqitjes së dokumentacionit justifikues ligjor është përcaktuar dhe në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur këtij ligji, dhe në mënyrë më të detajuar dhe në pikën 13 të udhëzimit nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, në të cilën parashikohet: “Deklarimi i pasurive të luajtshme, të regjistruara në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratën e shitblerjes dhe vërtetimin përkatës nga institucioni i zhdoganimit dhe i regjistrimit të kësaj pasurie”.* Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë arsyetimin e Komisionit në vendimin nr. 94, datë 21.12.2018, pika 3.14, paragrafi i dytë, se: [...] *pavarësisht se vlerësimi i mjetit është bërë nëpërmjet procedurës së referencës doganore, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte bashkëlidhur dhe në dosjen e zhdoganimit, faturën e blerjes dhe kontratën e shitjes dhe mbi këtë bazë paguhet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, referuar ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 [...].*
74. *Subjekti në ankim pretendon se mungesa e seriozitetit të arsyetimit dhe përpilimit të vendimit nga Komisioni, shprehet dhe në mosparaqitjen e saktë të të dhënave që mbart prova. Në asnjë provë të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk përshkruhet se ai ka në pronësi një automjet “Mercedes Benz”, Marka X3. Në tërësi të vendimit nr. 94, datë 21.12.2018, të Komisionit konstatohen shumë gabime në shkrim, interpretim i gabuar i provave dhe arsyetim alogjik, të*

¹⁸ Shfuqizuar me ligjin nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

cilat dhe mund të konsiderohet se janë vendosur me dashje nga Komisioni dhe duhet të passjellin pavlefshmërinë e tij.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson si gabim material në vendimin e Komisionit faktin e përcaktimit të automjetit BMW, X3 si automjet “Mercedes Benz”, por ky fakt nuk afekton rezultatin mbi këtë pasuri. Nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit, trupi gjykues nuk konstaton gabime në shkrim, interpretim të gabuar të provave apo arsyetim alogjik që të sjellin pavlefshmërinë tij, si pretendon subjekti në ankim.

75. *Subjekti shprehet në ankim se nuk është dakord me analizën financiare të vitit 2012 të Komisionit (Tabela nr. 2, analiza financiare për vitin 2012), pasi kjo tabelë nuk përmban ekstremitetet, shpjegimet për të dhënat e pasqyruara, si dhe nuk pasqyron me vërtetësi gjendjen e shifrave, sipas deklaratës “vetting” apo deklaratës së interesave privatë të vitit 2012. Tabela përmban informacion jo të saktë dhe të plotë. Në të nuk pasqyrohen gjendja e mjeteve monetare dhe kapitaleve në fillim të periudhës kalendarike, pra gjendjet e datës 31.12.2011.*
76. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se tabela përmban shpjegimet për të dhënat e pasqyruara me vërtetësi, duke harmonizuar gjendjen e pasurive, likuiditeteve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe shifrat bazuar në dokumentacionin ligjor të dosjes gjyqësore. Edhe nëse ekstremitetet nuk pasqyrohen qartë, kjo nuk cenon rezultatin e kësaj analize. Pretendimi i subjektit se Komisioni nuk kishte marrë në konsideratë gjendjen financiare të vitit 2011 nuk qëndron, pasi subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2011 kursime *cash* në fund të këtij viti. Nga analiza financiare e kryer në Komision, për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me teprice financiare në vlerën 4200 lekë sipas tabelës nr. 4, “Analiza financiare përfundimtare”, të vendimit të Komisionit. Kjo teprice tregon se subjekti i rivlerësimit justifikon me burime të ligjshme pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera në vitin 2011, por nuk mund të konsiderohen kursime tepricat nëse nuk deklarohen si të tilla në deklaratën e interesave privatë të vitit përkatës dhe më pas të përfshihen në analizën financiare të vitit/viteve pasardhëse.
77. *Referuar pretendimit të subjektit se bazuar në nenin 227 të Kodit të Procedurës Civile, dhe në vendimin nr. 19/2005¹⁹ të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji me kërkesën e subjektit të rivlerësimit apo dhe kryesisht duhet të kërkojë sqarime plotësuese ose të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri duke thirrur ekspertë të tjerë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni dhe Kolegji në shqyrtimin e çështjeve asistohen nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, sipas përcaktimeve të neneve 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë nuk është një proces vlerësimi vetëm financiar, por një balancë mes interpretimit ligjor dhe analizës financiare për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Trupi gjykues vlerëson se Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur Komisionin dhe Kolegjin me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve bazuar në një analizë të*

¹⁹ “[...] neni 224b/2 i Kodit të Procedurës Civile, trajton vlerën provuese të mendimit të ekspertit, ndërsa neni 229 i po këtij Kodi, rregullon mënyrën e procedimit të gjykatës në rastet kur shihet se ekspertimi është i metë ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve. Siç shihet, këto dy dispozita ofrojnë alternativa procedimi, zgjedhja e të cilave është lënë në vlerësim të gjykatave të zakonshme. Në rastin në shqyrtim, gjykata e apelit, duke zgjedhur alternativën e parë, pra, atë që parashikon neni 224/b/2 i Kodit të Procedurës Civile, pas një vlerësimi në tërësi të provave dhe të rrethanave të çështjes, si dhe duke përmbushur kushtin e vendosur në këtë dispozitë për arsyetimin me hollësi, ka arritur në një mendim të ndryshëm me atë të ekspertëve. Duke vepruar në këtë mënyrë, kjo gjykatë ka respektuar dispozitat përkatëse procedurale për marrjen e provave”.

saktë dhe shteruese të provave të administruara. Në konkluzion, për këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se është i pabazuar.

78. *Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk është dakord me analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2012, pasi tabela nr. 2 në vendimin nr. 94, datë 21.12.2018, të Komisionit, nuk përmban ekstremitetet, shpjegimet për të dhënat e pasqyruara, si dhe nuk pasqyron me vërtetësi gjendjen e shifrave, sipas deklaratës “vetting” apo deklaratës së interesave privatë të vitit 2012, si dhe nuk pasqyrohet gjendja e mjeteve monetare dhe kapitaleve në fillim të periudhës kalendarike, pasi referuar ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, [...], ndryshuar me ligjin nr. 42/2017, datë 06.04.2017, subjekti ka qenë i detyruar të pasqyrojë shtesat dhe pakësimet e pasurisë, si dhe burimet e krijimit të tyre nga deklarimi i mëparshëm deri në datën 31 dhjetor të vitit të deklarimit, trupi gjykues i Kolegjit arsyeton, së pari, se mungesa e ekstremiteve apo shpjegimeve në tabelë është plotësuar me shpjegimet e dhëna për analizën financiare subjektit, me rezultatet e hetimit administrativ, me kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të cilat subjekti ka parashtruar shpjegime dhe ka paraqitur aktekspertimin. Mungesa e ekstremiteve në tabelë nuk sjell për pasojë ndryshimin e rezultatit të analizës financiare të kryer. Së dyti, ndryshe nga sa pretendon në ankim, subjekti nuk ka deklaruar saktë shtesat apo pakësimet e pasurisë në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë për vitet 2003-2016. Konkretisht, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar gjendje likuiditeti/kursime në *cash*, në fund të vitit 2011. Ndërsa në fund të vitit 2012, pretendon të ketë pasur kursime në *cash* në vlerën 46.125 euro. Nga përpunimi matematikor i deklarimeve të subjektit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, trupit gjykues në Kolegj i rezulton që gjendja e likuiditeteve në *cash* e subjektit të jetë 39.625 euro dhe jo sa pretendon dhe ka konsideruar subjekti në aktekspertimin financiar për vitin 2012, ku konsideron shtesat e gjendjes së arkës në euro më 31.12.2012, në vlerën 46.625 euro. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.*
79. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk është marrë në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2012, gjendja financiare e vitit 2011, nuk qëndron, pasi në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar gjendje likuiditeti jashtë sektorit bankar/kursime në *cash*. Teprica pozitive e përlllogaritur nga Komisioni për vitin 2011, në vlerën 4.200 lekë, tregon se për këtë vit, subjekti dhe personat e lidhur justifikojnë shpenzimet e kryera gjatë këtij viti, por nuk është gjendje likuiditeti/kursim në *cash* i deklaruar që mund të mbartet si gjendje në fillim të periudhës për vitin pasardhës. Për më tepër, kur nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë kursim i përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie në vitin/vitet pasardhës.
80. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për analizën e rishikuar nga Komisioni, sipas të cilit Komisioni duhet të merrte në konsideratë vetëm efektin e ndryshimit të kursit të këmbimit euro/lekë të vitit 2008 në vitin 2012, ndërkohë që në analizën e rishikuar ka ndryshime në zërat, ndryshim i pasurive, likuiditete, të ardhura dhe efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit, pas analizimit të pasqyrës financiare të Komisionit për vitin 2012, paraqitur në vendim, trupi gjykues konstaton se të dhënat e analizës financiare të rishikuar nga Komisioni, pas parashtrimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, dokumentacionit justifikues ligjor të administruar dhe vlerësimit ligjor të kryer, kanë korrigjuar analizën e Komisionit sipas rezultateve të hetimit. Konkretisht, në analizën e rishikuar, Komisioni me të drejtë ka sistemuar diferencën e kursit të këmbimit duke shtuar në zërin “të*

ardhura”, “efektin e kursit të këmbimit” në vlerën 737986 lekë, pasi shuma e përfituar nga subjekti nga *zgjidhje kontrate porosie* nr. {***} rep., nr. {***} kol., më datë 24.03.2012, nuk mund të konvertohej me kursin e këmbimit të vitit 2008. Për ndryshimet në zërat e tjerë të *analizës së rishikuar kundrejt analizës sipas rezultateve të hetimit*, trupi gjykues konstaton se Komisioni me të drejtë ka marrë në konsideratë të dhënat nga dokumentacioni provues ligjor i administruar, si paga neto e personave të lidhur apo ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve.

81. Për pasurinë automjet i markës BMW, X3, në deklaratën për rivlerësimin e pasurisë, *vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të *ardhurat familjare dhe të ardhura nga shitja e automjetit me targë* {***}, *sipas kontratës shitje-blerje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2012, në shumën 3.000 euro, me kurs 140 lekë/euro*. Nga analizimi i kontratës së shitblerjes së automjetit të markës “Mercedes Benz”, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.12.2012, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se të ardhurat nga shitja e automjetit më sipër, më datë 18.12.2012, nuk mund të kenë shërbyer për blerjen e automjetit të markës BMW, X3, në Gjermani, më datë 26.11.2012 (22 ditë më përpara), ashtu si deklaroi subjekti në deklaratën për rivlerësimin e pasurisë, *vetting*.
82. *Subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë mospërputhje mendimi dhe koncepti financiar midis asaj që është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit dhe pjesës së rishikimit të analizës financiare të realizuar nga Komisioni. Për të provuar sa më sipër, subjekti ka paraqitur analizën financiare për vitin 2012, të përgatitur nga eksperti i zgjedhur prej tij, duke konkluduar se për vitin 2012, në kohën kur është blerë automjeti me targë {***}, nga analiza financiare rezulton se nuk ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare, të ardhurat e krijuara me shpenzimet e kryera janë të balancuara dhe nuk ka diferencë në vlerë, si dhe burimet e financimit të tyre janë të ligjshme.* Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk qëndron pasi, vetëm nga korrektimi i përlllogaritjes së gabuar të kostos vjetore për konsum/shpenzimeve jetike në vlerën 939216 lekë (4 anëtarë x 12 muaj x 19567 lekë për frymë në muaj) nga 883722 lekë, të konsideruar nga eksperti kontabël i subjektit, në analizën financiare të kryer prej tij për vitin 2012, rezulton mungesë e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në këtë vit në vlerën 55494 lekë. Diferenca negative rritet nëse të ardhurat nga pagat e personave të lidhur, bashkëshortes dhe vajzës do të konsideroheshin sipas të dhënave në dokumentacionin provues ligjor të administruar. Bazuar në arsyetimin më sipër, rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur të kenë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen automjetit BMW, X3, në vitin 2012, sipas përcaktimeve në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
83. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie u bazua në aktet si më poshtë.
- i. Deklarata e pasurisë “vetting” e vitit 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së.
 - ii. Deklarata e interesave private të viteve 2011 dhe 2012.
 - iii. Shkresë nr. {***} prot., datë 07.02.2018, e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë.
 - iv. Shkresë nr. {***} prot., datë 11.12.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega Doganore Berat (praktika doganore Imp. {***}, me {***}, datë 13.01.2013).
 - v. Shkresë nr. {***} prot., datë 14.02.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për automjetet {***} dhe {***} dhe dokumentacioni shoqërues.

- vi. Vërtetim i datës 24.01.2017, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale Berat, me dokumentacionin shoqërues.
- vii. Akt ekspertimi B.Ç., person fizik, licenca nr. {***}, datë 26.02.2005, NIPT: {***}.
- viii. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

Për pasurinë letra me vlerë në obligacione thesari në Raiffeisen Bank

84. Komisioni për këtë pasuri ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit *ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar dy depozitat e krijuara: (1) pranë “ProCredit Bank” në shumën 3600 euro + 320000 lekë dhe (2) pranë “Raiffeisen Bank” në shumën prej 185571 lekësh, depozita të cilat kanë shërbyer si burim fillestar për krijimin e shumës 2.100.000 lekë.*
85. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Letra me vlerë në obligacione thesari, blerë në Raiffeisen Bank, më datë 06.07.2015, në shumën 2.100.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhura familjare.*
Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, kjo pasuri është deklaruar për herë të parë, si vijon: *Blerje obligacione të thesarit në Raiffeisen Bank, me afat 36 muaj nga data 06.07.2015, me maturim të interesave në çdo gjashtë muaj, shtuar në vlerën 2.100.000 lekë. Burimi: Mbyllja e llogarisë së depozitës në ProCredit Bank.*
86. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit në Bankën ProCredit ShA, përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 12.02.2018, rezultoi se më datë 26.06.2015 është transferuar shuma 2.143.609 lekë nga llogaria rrjedhëse e subjektit të rivlerësimit në bankën Procredit Sh.A në llogarinë e tij pranë Bankës Raiffeisen ShA. Banka Raiffeisen Sh.A, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.01.2018, konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka investuar në obligacione shumën 2.100.000 lekë më datë 06.07.2015, me datë maturimi 06.07.2018. Nga shqyrtimi analitik i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur në bankën ProCredit ShA, rezultoi se origjina e depozitës që ka shërbyer si burim krijimi për obligacione thesari, kanë qenë shumat 3600 euro dhe 320000 lekë, të depozituara në vitin 2004 në këtë bankë. Si burim krijimi të depozitave më sipër, kanë qenë gjendja financiare deri në datën 31.12.2002, gjendja në shtëpi në *cash* në shumën 600.000 lekë dhe gjendja në bankë në shumën 800 euro, ka deklaruar subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ.
87. Lidhur me pretendimin më sipër dhe faktin që shuma 800 euro në llogari rrjedhëse në bankën Procredit Sh.A dhe gjendja e likuiditeteve në *cash* në shumën 600.000 lekë përpara vitit 2003, kanë qenë *momenti i fillimit [...] të pasurisë, që ka shërbyer si burim fillestar për krijimin e shumës 2.100.000 lekë*, trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i deklaratës për herë të parë të pasurisë në vitin 2003, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh në sistemin bankar apo në *cash*. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit deklaroi një llogari bankare në Bankën ProCredit ShA, Berat, në vlerën 3.600 euro dhe 320.000 lekë, pa përcaktuar burimin e krijimit të kësaj pasurie.
Duke qenë se gjendja e likuiditeteve në *cash*, e mbartur nga viti 2002, në vlerën 600.000 lekë si pretendon subjekti, *nuk është deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë të vitit 2003*, me të drejtë nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Detyrimi i subjektit ka qenë deklarimi i saktë i të gjitha pasurive të akumuluar, detyrimeve financiare dhe

burimeve të origjinës së tyre deri më 31 dhjetor 2003, dhe jo vetëm shtimet apo pakësimet e ndodhura gjatë vitit 2003. Në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të ardhura të ligjshme konsiderohen ato të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, në mungesë të deklarimit të gjendjes *cash* nga subjekti, nuk mund të merret në konsideratë kjo shumë, duke vlerësuar të drejtë qëndrimin e Komisionit në vendim. Ndërsa sa i përket shumës 800 euro, nga analiza e balancave të llogarive të subjektit dhe personave të lidhur në bankën Procredit Sh.A, *nuk ka rezultuar që subjekti dhe personat e lidhur të kenë pasur gjendje likuiditetesh në këtë bankë më 31.12.2003.*

Subjekti pretendon se me të drejtën që i jep ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, ka bërë korrigjimet e duhura në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, dhe deklaroi për herë të parë gjendjen e pasurisë të mbartur deri në datën 31.12.2002. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi nga analizimi i deklaratës së interesave privatë të vitit 2004, nuk konstaton të jetë korrigjuar deklarimi i likuiditeteve në “cash” mbartur nga viti 2002, në vlerën 600.000 lekë dhe shuma 800 euro në llogari rrjedhëse, në bankën Procredit Sh.A.

88. Në vijim, në ankim subjekti pretendon se gjendja *cash* në fund të vitit 2004 është shtuar me 200.000 lekë (1.200.000 lekë të ardhura – 1.000.000 lekë shpenzime) dhe pakësuar me 776.264 lekë. Sipas subjektit, kanë mbetur jashtë banke 23.736 lekë dhe janë depozituar në bankë 3.600 euro dhe 320.000 lekë, duke e marrë të mirëqenë ekzistencën e gjendjes *cash* në banesë, në shumën 600.000 lekë në fund të vitit 2003. Me këto pretendime, subjekti bie në kundërshtim me sa ka deklaruar më sipër, pasi nëse do të kishte gjendje 800 euro në bankë në fund të vitit 2003, të konvertuara me 126,74 lekë/euro, do të ishin 101.392 lekë. Deklarimi i pasurisë së luajtshme në deklaratën e vitit 2004, duhet të ishte bërë: *shtesë e gjendjes së likuiditeteve në llogarinë bankare në ProCredit ShA, në shumën 354.872 lekë ose 2.800 euro*, dhe jo si e ka pasqyruar subjekti “3.600 euro”. Në deklaratën e interesave të vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar as vlerën 23.736 lekë, si gjendje në *cash* të pretenduar prej tij në ankim. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2004, rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk justifikojnë me të ardhura nga burime të ligjshme krijimin e kursimeve në llogari bankare, në vlerën 783.727 lekë.
89. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se shumat 600.000 lekë dhe 800 euro kanë qenë burim fillestar për krijimin e shumës 2.100.000 lekë, ndërkohë që nga sa arsyetuar më sipër, shuma 600.000 lekë nuk është deklaruar, shuma 800 euro nuk ka ekzistuar në llogari bankare dhe subjekti nuk justifikon me të ardhura nga burime të ligjshme depozitat e krijuara në vitin 2004, të cilat janë origjinë e shumës 2.143.609 lekë, tërhequr nga llogaria rrjedhëse e subjektit në bankën Procredit ShA, për t’u investuar në shumën 2.100.000 lekë, për blerje obligacionesh në bankën Raiffeisen ShA, më datë 06.07.2015. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.
90. Arsyetimi i mësipërm për vlerësimin e kësaj pasurie u bazua në aktet e mëposhtme.
- i. Deklarata “vetting” e vitit 2017 dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së.
 - ii. Deklarata e pasurisë e vitit 2003.
 - iii. Deklarata e interesave privatë të vitit 2004 deri 2015.
 - iv. Vërtetim nr. {***} prot., datë 11.01.2017, nga Raiffeisen Bank, ku vërtetohen obligacionet në vlerën 2.100.000 lekë.

- v. Vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 14.07.2015, “Mbi shpalljen fitues” të ankandit nr. {***}.
- vi. Shkresa nr. {***} prot., datë 30.01.2018, e Raiffeisen Bank, ku konfirmohet se subjekti disponon bono thesari në vlerën 2.100.000 lekë.
- vii. Shkresa nr. {***} prot., datë 12.02.2018, e ProCredit Bank.
- viii. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

Për të ardhurat dhe shpenzimet e shkollimit për personin e lidhur – djali i subjektit, z. E.V.

- 91. Komisioni, në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e personit të lidhur/djali i subjektit, z. E.V., ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: i) *ka fshehur në deklaratën “vetting” për vitin 2017, detyrimin e personit të lidhur/djalit të tij ndaj shtetasit L.B., në shumën 18.230,90 USD, transferuar në vitin 2016; ii) nuk provoi se sponsorizuesi L.B. kishte mundësi financiare nga burime të ligjshme për të dhënë huan në vitin 2016 dhe më tej në vitin 2017; iii) ka kryer deklaram të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shkollimin dhe akomodimin e personit të lidhur/djalit të tij në ShBA.*
- 92. Nga analizimi i deklaratës së interesave privatë të vitit 2017, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se personi i lidhur E.V. ka nisur studimet master në {***}, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në shtator të vitit 2016. Shpenzimet gjithsej të studimeve (për periudhën shtator 2016 - dhjetor 2017) janë deklaruar në vlerën 76.016,45 USD, prej të cilave 64.020,04 USD për shkollimin: vjeshtë 2016, 18.230,90 USD; pranverë 2017, 23.242,14 USD; dhe vjeshtë 2017, 22.548,80 USD), si dhe 11.994,41 USD për shpenzimet e jetesës.
- 93. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, djali i tij E.V., nuk kanë deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësim *vetting* 2017, të dorëzuar në ILDKPKI më datë 31.01.2017, detyrimin financiar ndaj shtetasit L.B.
- 94. Burimin e të ardhurave të përdorura për të mbuluar shpenzimet e studimeve të personit të lidhur, djalit të subjektit, e konstatojmë të deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2017, ku E.V. deklaroi *të ardhura për studime nga z. L.B., gjithsej në shumën \$34.965, nga këto \$ 19.625 transferta në datën 19.12.2016 nga BKT, Shqipëri në llogarinë rrjedhëse të z. E.V. në Bank of America, USA; \$ 15.000, transferta në datën 12.04.2017 nga Raiffeisen Bank, Shqipëri në llogarinë rrjedhëse bankare të {***}, {***}, USA për studentin E.V.*
- 95. Nga analizimi i deklaratës së interesave privatë të vitit 2016, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar detyrimin ndaj shtetasit L.B., në shumën prej 18.230.90 USD, dhe detyrimin ligjor për të deklaruar shpenzimet me vlerë mbi 300.000 lekë, të përdorura për arsim deri në datën 31 dhjetor të vitit 2016, si dhe detyrimin të deklarojë detyrimet ndaj personit fizik (kredi, huamarrje, detyrime ndaj të tretëve etj.) për detyrimet e lindura gjatë vitit të deklaramit, në zbatim të nenit 4, geramat “dh” dhe “h” të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar.
- 96. Duke qenë se personi i lidhur, djali i subjektit, z. E.V., ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2017, detyrimin financiar ndaj shtetasit L.B., *për shumën 34.965 USD, me 0 (zero) interes dhe shlyerja do të fillojë pas përfundimit të studimeve, me fillimin e marrëdhënieve të punës*, trupit gjykues në Kolegj, pas shqyrtimit të dosjes gjyqësore, nuk i rezulton të jetë dorëzuar dokument ligjor me të cilin të provohet marrëdhënia juridike konkrete ku të përcaktohet objekti, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe lloji i detyrimit, kredi, dhuratë, huadhënie, afati dhe mënyra e shlyerjes së detyrimit. Vetëdeklarimi i kësaj marrëdhënieje detyrimi gjatë hetimit

administrativ të kryer në Komision, i jep shtetasit L.B. cilësinë e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Për sa më sipër, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, dhe të pikës 19 të udhëzimit nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së: Nëse personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit deklarojnë një marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit, detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të depozitohet dokumentacion justifikues ligjor për shumën 18230 USD, të transferuar në llogarinë bankare të z. E.V. në Bank of America, N.A.*

97. Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e pasurisë *vetting* detyrimin e personit të lidhur, ndaj L.B., në shumën 18230,90 USD, transferuar në vitin 2016, pasi në interpretim të provave të administruara dhe të provave të tjera të paraqitura nga subjekti, si deklarata interesave privatë vjetorë 2017, provohet e kundërta. Sipas subjektit, ky fakt nuk konsiderohet fshehje e të dhënave (detyrimeve) në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi fshehja si koncept kërkon domosdoshmërisht shmangien me qëllim nga deklarimi i të dhënave pasurore për shkak se nuk mund të justifikohet ligjshmëria e burimit të tyre, ndërkohë që personi i lidhur e ka pasqyruar ekzistencën e plotë të detyrimeve për shkollimin e tij në ShBA dhe burimin e ligjshmërisë së lindjes së këtij detyrimi në deklaratën e interesave privatë të vitit 2017. Në rastin më të keq, mund të konsiderohet një pakujdesi në deklarimin e të dhënave në deklaratën e pasurisë *vetting*.
98. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me këtë pretendim, vlerëson se në zbatim të nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, *subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2, në të cilën përcaktohet qartë detyrimi i subjektit për të deklaruar detyrimet financiare të tij apo të personit të lidhur ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetur ende pa u shlyer deri në datën e deklarimit. Ndodhur në kushtet kur si subjekti, ashtu dhe personi i lidhur, djali, nuk kanë deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësim *vetting*, shpenzimet e shkollimit dhe detyrimin financiar ndaj shtetasit L.B., trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e pasurisë *vetting* detyrimin financiar ndaj shtetasit L.B., sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.*
99. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit është kontradiktor në qëndrimet e tij në lidhje me cilësimin e marrëdhënies juridike të personit të lidhur me shtetasin L.B., pasi në pyetësor e cilëson si sponsor, gjatë seancës dëgjimore nuk e konsideron as dhurues dhe as sponsor, por garantues-mbështetës. Në lidhje me këtë fakt, trupi gjykues vlerëson se Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, në asnjë dispozitë të tij nuk parashikon apo përdor termin “mbështetës” në një marrëdhënie juridiko-civile, por nisur nga sa deklaroi personi i lidhur në

deklaratën e interesave privatë të vitit 2017, se *do të kthejë financimin e përfituar nga L.B. pas fillimit të punës*, çmon se ndodhemi përpara një marrëdhënie detyrimi.

100. Lidhur me kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit në vendim se subjekti i rivlerësimit nuk provoi që sponsorizuesi L.B. kishte mundësi financiare nga burime të ligjshme për të dhënë hua në vitin 2016, e më tej në vitin 2017, trupi gjykues arsyeton:

Referuar lëvizjeve të llogarisë së djalit të subjektit, z. E.V., në Bank of America, rezultoi se më datë 21.12.2016, janë transferuar nga shtetasi L.B., bashkëshorti i motrës së subjektit, shuma 19965 USD, me përshkrimin: *transfer for studies of my nephew*.

Në shpjegimet e dhëna për rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit deklaroi se z. L.B. e ka pasur gjendje në llogari bankare shumë me të cilën ka mbështetur, sponsorizuar djalin e tij, E.V. Sa më sipër, provohet me vërtetimin nr. {***} prot., datë 03.05.2016, Banka Kombëtare Tregtare, dega Berat, referuar të cilit, më datë 03.05.2016, L.G.B. e ka 35000 euro balancën e llogarisë së tij në këtë bankë. Sipas subjektit, në shpjegimet për rezultatet e hetimit, burimet e krijimit të të ardhurave të kësaj depozite pasqyrohen në transaksionet bankare në llogaritë e tij si klient i bankës. Aktualisht, ky shtetas është emigrant në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nuk mund të merret informacioni nga banka për këtë llogari, pasi konsiderohen të dhëna konfidenciale.

101. Në vijim të shpjegimeve, subjekti pretendon se *mënyra e krijimit të burimit të të ardhurave mund të provohet dhe me qenien e bashkëshortëve L. dhe L.B. në marrëdhënie pune*. Vetëm pas kalimit me rezultatet e hetimit si barrë prove, subjekti ka depozituar vërtetime²⁰ të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Berat dhe Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë, të administruara në dosjen gjyqësore, për të provuar vjetërsinë në punë e shtetasve L. dhe L.B. e të ardhurat e realizuara prej tyre, prej vitit 2011 e në vazhdim.

102. Bazuar në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar lidhur me sa më sipër, u krye analiza financiare në Kolegj për të verifikuar mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, shtetasit L.B., dhe bashkëshortes të tij, që me të ardhura nga burime të ligjshme të kryente shpenzimet e jetesës (duke konsideruar shpenzime minimale jetike) dhe të kursente shumën 19965 USD ose ekuivalenten e saj, 15994 euro. Rezultatet e analizës financiare tregojnë se L.B. dhe bashkëshortja e tij ndodhen në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1463899 lekë për periudhën 2011-2016. Për rrjedhojë, ndodhur në kushtet e mosdeklarimit të depozitës bankare në shumën 35.000 euro të shtetasit L.B., si burim të ardhurash për likuidimin e tarifës studimore të z. E.V. në deklaratën periodike të vitit 2016 dhe deklaratën *vetting*, fakti që rezultatet e analizës financiare të kryer tregojnë se personi tjetër i lidhur, shtetasi L.B., nuk justifikon me të ardhura nga burime të ligjshme krijimin e depozitës bankare në shumën 35.000 euro, pranë Bankës Kombëtare Tregtare, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit

²⁰ Vërtetim nr. {***} prot., datë 11.12.2018; vërtetim nr. {***} prot., datë 11.12.2018; vërtetim “Për vjetërsinë në punë për efekt pensioni” nr. {***} prot., datë 11.12.2018; vërtetim “Për vjetërsinë në punë për efekt pensioni” nr. {***} prot., datë 11.12.2018; vërtetim “Për vjetërsinë në punë për efekt pensioni” nr. {***} prot., datë 11.12.2018; vërtetim “Për bazën e vlerësuar” nr. {***} prot., datë 11.12.2018; vërtetim për bazën e vlerësuar nr. {***} prot., datë 11.12.2018, të lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Berat; vërtetim datë 11.12.2018, nga Sh.A Ujësjiellës – Kanalizime, Berat Kucovë.

nr. 84/2016, e gjen të padrejtë pretendimin e subjektit se shtetasi L.B. kishte mundësi financiare për dhënien e kësaj shume.

103. Nga analizimi i llogarisë bankare të z. E.V. në bankën Raiffeisen ShA, rezulton të jenë derdhur prej tij, më datë 09.05.2016, 12.000 euro, me përshkrimin *të ardhura nga kursimet familjare*. Në konsideratë të faktit që në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, subjekti ka deklaruar se kursimet *cash* në shumën 1280275 lekë gjendje në datën 31.12.2015, i ka shpenzuar për udhëtimin e bërë në ShBA në gusht të këtij viti, u krye analiza financiare në Kolegj për vitin 2016, për të vlerësuar nëse subjekti dhe personat e lidhur justifikojnë me të ardhura nga burime të ligjshme, kursimet më sipër, shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara në këtë vit, nga ku rezultoi mungesë e burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1477.135 lekë.

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka fshehur detyrimin financiar për shkollimin e personit të lidhur E.V., ndaj shtetasit L.B., si dhe nuk ka burime të ligjshme, për të mbuluar këtë shpenzim, deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, sipas nenit 33, pika 5, gerrat "b" dhe "c" të ligjit nr. 84/2016.

104. Arsyetimi i mësipërm u bazua në aktet e mëposhtme.
- i. Deklarata e pasurisë "vetting" dhe dokumentacioni bashkëlidhur, dorëzuar pranë ILDKPKI-së.
 - ii. Deklarata e interesave privatë të vitit 2016.
 - iii. Vërtetim nr. {***} prot., datë 03.05.2016, lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare, dega Berat.
 - iv. Vërtetim nr. {***} prot., datë 11.12.2018. nga Drejtoria Rajonale Berat për L.B., e siguruar pranë ish-Ndërmarrjes Elektrike Berat, për periudhën 16.01.1993 deri 30.09.2011; në subjektin {***} për periudhën 01.01.2012 deri 31.01.2013, në subjektin {***} për periudhën 01.02.2013 deri 30.10.2018.
 - v. Vërtetim nr. {***} prot., datë 11.12.2018, Drejtoria Rajonale Berat, për L.B., rezulton i siguruar pranë subjektit Këshilli i Qarkut Berat për periudhën 01.01.2012 deri 31.12.2013, subjekti i {***} për periudhën 01.01.2014 deri 31.11.2014, subjekt person fizik "{***}" për periudhën 01.01.2016 deri në 30.10.2018.
 - vi. Vërtetim, datë 11.12.2018, nga Sh.A Ujësjetllës – Kanalizime, Berat Kuçovë, ku vërtetohet se L.B. ka qenë punonjës pranë kësaj shoqërie nga 01.05.1994 deri më 25.10.2011.
 - vii. Vërtetim "Për vjetërsinë në punë për efekt pensioni" nr. {***} prot., datë 11.12.2018, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat për L.B., ku pasqyrohet punësimi nga periudha 16.02.1987 deri 30.09.2011.
 - viii. Vërtetim "Për vjetërsinë në punë për efekt pensioni" nr. {***} prot., datë 11.12.2018, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat për L.B., ku pasqyrohet punësimi nga periudha 16.09.1987 deri 01.10.2010.
 - ix. Vërtetim "Për bazën e vlerësuar" nr. {***} prot., datë 11.12.2018, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat për L.B., ku pasqyrohen kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto, nga viti 2012.
 - x. Vërtetim për bazën e vlerësuar nr. {***} prot., datë 11.12.2018, për L.B. nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat, ku pasqyrohen kontributet mujore mbi bazën e pagës bruto, nga viti 2011.

- xi. Transaksionin nga Banka Kombëtare Tregtare, datë 19.12.2016, nga klienti L.B. për përfituesin E.V., për qëllime studimi.
- xii. Dokumentacion i depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

Për analizën financiare për periudhën 2003 – 2016

- 105. Për analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, të subjektit të rivlerësimit, bazuar në të dhënat e INSTAT-it dhe anketën familjare të vitit 2006 po nga INSTAT, Komisioni ka arritur në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë dhe ka mungesë të mjeteve financiare nga burime të ligjshme nga viti 2003 deri në vitin 2016, në shumën -5.708.665 lekë, për të justifikuar deklarimet e bëra ndër vite.*
- 106. *Subjekti në ankim pretendon se Komisioni, në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë dhe ka mungesë të mjeteve financiare nga burime të ligjshme nga viti 2003 deri 2016, në shumën -5.708.665 lekë, ka gabuar pasi në interpretim të provave të administruara dhe të provave të tjera të paraqitura nga subjekti, si analiza financiare, provohet e kundërta.*

Sa i përket këtij pretendimi, në Kolegj u krye analiza financiare, duke u mbështetur në deklarimet e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklaratat periodike, dokumentacionin justifikues ligjor të administruar në dosjen gjyqësore, nga subjekti i rivlerësimit dhe institucionet publike pas kërkesës së Komisionit gjatë hetimit administrativ, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Pas vlerësimit ligjor të kryer, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera gjatë periudhës së rivlerësimit 2003-2016.
- 107. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se analizat financiare të kryera nga Komisioni gjatë hetimit administrativ dhe pas seancës dëgjimore, paraqesin vlerësim të gabuar të të dhënave dhe deklarimeve vjetore për periudhën 2003-2016 dhe deklaratës së pasurisë *vetting*, konkretisht në lidhje me shpenzimet e minimumit jetik, pasi merr në konsideratë anketat e buxhetimit të njëjësive familjare, të kryera nga INSTAT.
- 108. Duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në ankim për të korrigjuar analizën financiare përfundimtare të Komisionit, u krye analiza financiare në Kolegj, duke përlloritur vlerat e shpenzimeve jetike sipas aktekspertimit paraqitur nga subjekti në ankim, për vitet për të cilat mungojnë të dhënat zyrtare nga INSTAT, si dhe në rastet kur ato rezultojnë të jenë më të larta se vlerat e shpenzimeve jetike sipas të dhënave zyrtare, përcjellë Kolegjit nga ILDKPKI/INSTAT me shkresën nr. {***} prot., datë 04.03.2019.
- 109. *Subjekti në ankim pretendon se deri më sot nuk ekziston ndonjë rregullim ligjor, VKM ose udhëzim në zbatim të ligjit nr. 84/2016, lëshuar nga ILDKPKI, për përcaktimin e shpenzimeve të minimumit jetik të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas vendbanimeve. Pra, Komisioni si gjatë hetimit paraprak, në seancë dëgjimore dhe sipas vendimit nr. 94, datë 21.12.2018, bazohet në të dhënat e grumbulluara dhe anketave të kryera në mënyrë rastësore. Nuk ka studim shkencor për diferencat e minimumit jetik sipas qarqeve dhe nivelit të jetesës. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi më sipër i subjektit nuk qëndron, pasi INSTAT është institucioni i vetëm përgjegjës që në funksion të kompetencave të tij ligjore, jep të dhëna zyrtare lidhur me shpenzimet jetike në Republikën e Shqipërisë, pa kategorizime apo mbështetur në profesione të caktuara.*

110. *Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim se në çdo tabelë të analizës financiare (për vitin 2004, 2012 dhe 2015), Komisioni ka pasqyruar tri kolona, analizën financiare sipas rezultateve të hetimit, analizën financiare pas prapësimeve të ekspertit dhe rishikimin e analizës financiare nga Komisioni, duke pranuar kështu që analiza financiare e kryer gjatë hetimit administrativ është me të meta dhe nuk pasqyron realitetin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se Komisioni, me të drejtë, ka rishikuar analizën financiare sipas rezultateve të hetimit, duke reflektuar ndryshimet në vlerësim të prapësimeve/shpjegimeve të dhëna nga subjekti për rezultatet e hetimit administrativ, kaluar si barrë prove në bazë të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*
111. *Subjekti në ankim pretendon se qëndrimi i Komisionit se: [...] çdo balancë pozitive që rezulton në fund të vitit, e deklaron kursime, gjendje cash për të nxjerrë balancë zero në fund të çdo viti dhe për ta pasqyruar si gjendje në fillim të vitit pasardhës. Subjekti i rivlerësimit e ka pasur detyrim ligjor që në deklaratat periodike vjetore të deklarojë kursimet, gjë të cilën nuk e ka bërë [...] –është i gabuar dhe i pabazuar në ligj. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që përveç shtesave dhe pakësimeve të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, burimin e krijimit të tyre, si dhe detyrimet financiare, në kuptim të nenit 4, pika “d” e këtij ligji, të deklaronte saktë edhe gjendjen e kursimeve në formë likuiditetesh cash apo në bankë në fund të çdo viti, prej vitit 2003 e në vazhdim, pasi analiza financiare mbështetet në deklaratimet e bëra nga subjekti, provuar me dokumentacion justifikues ligjor. Në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklaratat e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë në ILDKPKI, mund të përdoren si provë në vlerësimin e pasurisë nga Komisioni dhe Kolegji. Sa më sipër, nëse subjekti i rivlerësimit nuk deklaron kursimet apo përdorimin e tyre për të krijuar pasuri, ato nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare, në përmbushje të kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar tatimet.*
- Diferencat negative të rezultuara në fund të vitit nga përlllogaritjet në kuadër të analizës financiare të kryer për periudhën e rivlerësimit 2003-2016, tregojnë pamjaftueshmëri të të ardhurave nga burime financiare të ligjshme të subjektit për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vitin përkatës, përfshirë në pasuri edhe kursimet e deklaruara cash apo gjendje në llogari. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk deklaron kursimet apo përdorimin e tyre për të krijuar pasuri, ato nuk mund të merren në konsideratë në analizë. Sa më sipër, pretendimi i subjektit është i pabazuar.*
112. *Subjekti pretendon në ankim se Komisioni ka interpretuar me keqdashje konceptin “kursim” duke konsideruar si gjendje, rezultat të një sërë veprimesh financiare të të dhënave të deklarimeve të çdo viti, ka pasur qëllim të pasqyrojë një analizë financiare në vite.*
- Lidhur me këtë pretendim, diferenca të ardhura minus pasuri të krijuara, minus shpenzime të kryera, minus ndryshim i gjendjes së likuiditeteve nuk mat kursimin e subjektit dhe të personave të lidhur, por vlerëson nëse subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare që me të ardhurat e realizuara në vitin 2015, të justifikojnë pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera dhe kursimet e deklaruara. Kursimet në cash subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor që t’i deklarojë në deklaratën e interesave privatë periodikë dhe kur nuk i ka deklaruar, me të drejtë Komisioni del në përfundimin se eksperti kontabël në analizën e kryer çdo balancë pozitive që i rezulton në fund të vitit e deklaron kursim, gjendje cash për të nxjerrë*

balancën zero në fund të çdo viti dhe për ta pasqyruar si gjendje në fillim të vitit pasardhës. Eksperti i subjektit nuk merr në konsideratë në analizën e kryer shtesat apo pakësimet e gjendjes cash për vitet 2003-2011, ndërsa shtesa e deklaruar në vitin 2012 nuk përputhet me sa rezulton nga përlllogaritjet e kryera në bazë të deklarimeve të bëra nga vetë subjekti.

113. *Më të njëjtin arsyetim si më sipër, trupi gjykues gjen të pabazuar dhe pretendimin e subjektit se gjendja financiare e gjetur si rezultat i analizës financiare të çdo viti deklarimi, pozitive apo negative [...], duhet të merret në konsideratë në analizën financiare të vitit pasardhës, dhe në tërësi në vitet e deklarimit, pasi kështu do të kemi një pasqyrim ligjor dhe shkencor të analizës financiare për periudhën 2003-2016. Diferenca e gjetur në fund të çdo viti, sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni, nuk është gjendje likuiditetesh cash në arkë apo bankë, por tregues i mjaftueshmërisë apo pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të për krijimin e pasurisë, apo shpenzimi të kryer për vitin në analizë. Kursimet e deklaruara nga subjekti dhe personat e lidhur, në të gjitha rastet kur janë deklaruar se janë përdorur për krijimin e ndonjë pasurie apo shpenzimi të kryer në vitet pasardhëse, janë marrë në konsideratë në analizën e kryer.*
114. *Në konkluzion të analizës financiare të kryer në Kolegj për periudhën e rivlerësimit 2003-2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk justifikojnë me të ardhura nga burime financiare të ligjshme, pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara në vlerën 9.634.926 lekë. Edhe nëse në analizën financiare në Kolegj do të konsideroheshin shpenzimet për jetesë të njëjta me ato të përlllogaritura në aktekspertimin e paraqitur nga subjekti në Komision dhe bashkëlidhur ankimit, mungesa e burimeve financiare të ligjshme do të rezultonte në vlerën 9.496.915 lekë.*
115. *Në lidhje me analizën financiare për të vlerësuar mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit dhe të personave të lidhur me të, për periudhën 2003-2016, bazuar në përfundimet e arritura nga trupi gjykues pas analizimit ligjor të shkaqeve të ankimit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.*
116. *Arsyetimi i mësipërm u bazua në aktet e mëposhtme.*
 - i. *Deklarata e pasurisë (vetting) 2017, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur.*
 - ii. *Deklarata e pasurisë për herë të parë, në vitin 2003.*
 - iii. *Deklaratat e interesave privatë për vitet 2004 - 2016.*
 - iv. *Aktekspertimi nga ekspert kontabël i miratuar, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.*
 - v. *Shkresa nr. {***} prot., datë 04.03.2019, e ILDKPKI-së.*
 - vi. *Dokumentacioni i përcjellë nga bankat e nivelit të dytë.*
 - vii. *Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit.*
117. *Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi çështjen në tërësi, shkaqet e ankimit, provat e administruara në këtë çështje, arrin në përfundimet se:*
 - i. *Për pasurinë, apartament banimi me sipërfaqe 110,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 17,20 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të*

justifikuar këtë pasuri, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.

ii. *Për pasurinë, automjeti BMW, X3*, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

iii. *Për pasurinë, letra me vlerë në obligacione thesari në Raiffeisen Bank*, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

iv. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur detyrimin financiar për shkollimin e personit të lidhur E.V., ndaj shtetasit L.B., si dhe nuk ka burime të ligjshme për të mbuluar këtë shpenzim, deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, sipas nenit 33, pika 5, germat "b" dhe “c” të ligjit nr. 84/2016.

v. Për analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, Kolegji çmon të drejtë konkluzionin e Komisionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

118. Trupi gjykues, në mbështetje të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se vendimi nr. 94, datë 21.12.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbështetur në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 94, datë 21.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Agron Vavla.
2. Ky vendim është përfundimtar, me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.07.2020.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Luan DACI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi